

Keydes për diktografimin. Konkretnisht i mbajtur me laps në dorë të diktografistit. Konkretnisht jashtë laponit, që me jo të munduruar me detyrë të kushtit ose shprehur do të diktografistit i fiksuar. Atje me njëzet konkrètement të rritur 3 pjesë të mbajtur në diktografim.

ALI DHRIMO

VËZHGIME RRETH NGULITJES SË NORMËS GJUHËSORE NË PUBLICISTIKËN E PASÇLIRIMIT

Një nga problemet më të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare është edhe studimi i gjuhës sonë letrare kombëtare, i fillimeve të saj, i zhvillimit dhe i kristalizimit gradual të normave të përbashkëta në këtë gjuhë¹.

Meqenëse tipari themelor i gjuhës së zhvilluar kombëtare është prania e një gjuhe letrare të normuar, të përgjithshme, për mbarë kombin dhe që përfshin gjithë sferat e komunikimit e që mbështetet në bazë popullore, atëhere studimi i zhvillimit dhe përforcimit të normave letrare kombëtare bëhet një nga detyrat më të ngutshme.

Gjuha letrare shqipe, siç nënvizon me të drejtë A. Kostallari, «u themelua në periudhën e pushtimit të huaj që vazhdonte prej disa shekujsh e të lëvizjes së fuqishme të çlirimit kombëtar që çoi në likuidimin e këtij pushtimi»². Në evolucionin e kësaj shqipeje letrare gati njëqindvjeçare, si etapë e tretë dhe e kristalizimit përfundimtar të normës së përbashkët letrare kombëtare njihet periudha prej vitit 1944 e deri në ditët tona³. Dhe kjo është krejt e kuptueshme: në këtë periudhë të ndritur të historisë së popullit tonë u rrit jo vetëm bashkëveprimi ndër-dialektor (ndryshoi përbërja e banorëve tona, u shtua numri i qyteteve, u qyteteve, u fut elementi i ri kulturor, ekonomik e administrativ në çdo fshat; nga zhvillimi i paparë ekonomik që mori vendi ynë, u zgjerua në mënyrë të pakrahasueshme bashkëjetesa vëllazërore e shqiptarëve me prejardhje krejt të ndryshme krahinore në ndërmarrjet, kantieret e gjithë frontet e prodhimit), por u rrit njëkohësisht edhe uniteti shpirtëror, vetëdija politike e shqiptarëve. Një rol vendimtar në njësimin e shqipes letrare kanë luajtur në radhë të parë hapja anë e kënd Shqipërisë e shkollave, përhapja e botimeve (para së gjithash e shtypit të partisë) dhe radioja.

Për gjuhën letrare, në variantin e saj të shkruar, një rol shumë të madh në formimin, zhvillimin e normimit e saj luan letërsia artistike me gjinitë e saj dhe publicistika. Për raportin midis tyre nuk mund të pohojmë në mënyrë të prerë se cila luan rol më të madh në kristalizimin e normës së përbashkët letrare kombëtare, por mund të vërejmë që publicistika është më masive, lexohet nga të gjithë njerëzit e shoqërisë sonë, pavarësisht nga formimi dhe shijet e tyre artistike; së dyti, lexohet

1) Në këtë drejtim një hap të rëndësishëm përbën artikulli i A. Kostallarit, **Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare**, në «Shkencaat shoqërore në shkollë», Tiranë, 1967; Mendime dhe kontribute rreth normës së përbashkët letrare kombëtare jepen edhe në një artikull tjetër të A. Kostallarit, **Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»**, «Studime filologjike», 1968, 2.

2, 3) A. Kostallari, **Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare**, 62, 65.

vazhdimisht, (përditë, kurse jo çdo njeri lexon përditë letërsi artistike) dhe, së treti, ndërsa në letërsinë tonë diferencimet dialektore vazhduan mjaft gjatë edhe pas 1944-s (pjesërisht vazhdojnë edhe sot), publicistika, për vetë natyrën e saj, si zëdhënese e gjuhës zyrtare, qysh në vitet e para pas çlirimit del, vërtetë jo me forma të njësuar, por së paku, me një mbi-zotërim deridiku të qartë të variantit jugor të pasuruar me mjaft elementë të dialektit verior.

Duke folur për rëndësinë e madhe që ka gjuha e shtypit si gjuhë e partisë, Stalini thekson se «shtypi është i vetmi mjet, me anën e të cilit partia flet përditë dhe për çdo orë me klasën punëtore në gjuhën që i nevojitet asaj»⁴. Shtypi ynë i ri socialist lindi në ditët më të rënda, por më të lavdishme për popullin tonë, në ditët e luftës së përgjakshme kundër pushtuesit të huaj dhe shërbëtorëve të tij. Ai u bë shprehësi i idealeve të këtij populli të shumëvujtur, u bë sqaruesi dhe mobilizuesi i ndërgjegjshëm i tij për një luftë pa kompromis kundër pushtuesit dhe errësirës shekullore.

Edhe nga pikëpamja gjuhësore shtypi ynë vazhdoi dhe çoi më tej traditat më të mira të publicistikës së paraçlirimit. Por, duke dalë në rrethana të tilla, me artikuj të shkruar me ngut nga njerëz me prejardhje të ndryshme krahinore e, për më tepër, në një kohë kur gjuha e shkruar (në përgjithësi) nuk kishte asnjë karakter normativ të caktuar, — në të haseshin forma me prejardhje dialektore krejt të ndryshme, nuk kishte asnjë përpjekje për koodifikimin e një gjuhe letrare të përbashkët kombëtare⁵, — është krejt e qartë, pra, se as që mund të bëhet fjalë për një gjuhë letrare të normuar në gazetën ilegale. Në këto rrethana, gjuha e «Zërit të Popullit» të atyre viteve është heterogjene, me trajta dialektore e nëndialektore dhe me përzierje formash pothuajse pa kriter në të njëjtin artikull. Por me gjithë këtë larmi, gjuhën e kësaj gazete që delte e shaptilografuar, e karakterizon thjeshtësia, afërsia me gjuhën e folur popullore; ndonëse shpeshherë dialektore, kjo gjuhë ishte e thjeshtë e qartë dhe e kuptueshme nga gjithë masat e popullit tonë, 85% e të cilit asokohe ishte analfabet.

Përzierja e theksuar e formave të dialekteve të ndryshme në të njëjtin artikull në «Zërin e Popullit» që delte gjatë luftës, mendojmë se mund të shpjegohet pikërisht me mungesën e një gjuhe letrare të normuar, por edhe me vazhdimin e një prirjeje, të nisur qysh para atyre viteve, për një përzierje mekanike të dy dialekteve të shqipes.

Në këtë artikull do të përipiqemi të vëmë në dukje disa nga ndryshimet që ka pësuar gjatë këtyre 25 vjetëve vetëm njëri nga sistemet gjuhësore dhe ngulitjen ose prirjen e normës në këtë sistem — në sistemin nominal⁶ në publicistikën tonë të pasçlirimit. Vëzhgimet kryesore mbështeten në materialet e «Zërit të popullit» për periudhën 1942-1968, por në disa raste, për çështje mjaft të diskutueshme, është bërë përqasje

4) J.V. Stalin, **Mbi shtypin**, bot. 1926, 22 — cituar sipas «Gjuha e gazetës bolshevike», Tiranë, 1950, 10-11.

5) Për këtë mjafton të shqyrtohet goftë gjuha e letërsisë artistike të atyre viteve, goftë gjuha e gazetave të ndryshme të asaj kohe, si p.sh. *Arbënia, Bashkimi i Kombit, Besa, Drita* etj.

6) Termin sistem *nominal* do ta marrim në kuptimin e tij të gjerë, d.m.th. si sistem që përfshin *çmrat, mbiemrat, përemrat* dhe *nyjën* (pavarësisht nga rezervat që kemi për këtë të fundit, nëse përbën pjesë ligjërata apo jo, prapëseprapë këtu po e trajtojmë, sepse nyja e përparme paraqet disa probleme lidhur me zbatimin praktik të normës).

edhe me material nga gazetat «Bashkimi», «Puna», «Sporti popullor» e «Zëri i rinisë». «Zëri i popullit» qysh nga numri i parë e deri në çlirimin e vendit tonë është vjelë në mënyrë shteruese për të gjitha çështjet gjuhësore që trajtohen në këtë artikull. Për materialin pas çlirimit u kalua në vjelje sistematike të një numri në muaj, duke u ndjekur gjithashtu në mënyrë shteruese të gjitha çështjet që trajtohen. Në bazë të këtij materiali që u grumbullua, për periudha të ndryshme për disa çështje janë dhënë edhe statistika mbi zotërimin e njërës apo tjetrës shfaqje. Edhe kur është dhënë një statistikë për një vit të vetëm ose për një gjashtëmuaj, kjo periudhë është ndjekur sistematikisht e jo me kapërcime ose me material të rastit. Megjithatë, përderisa një vjelje shteruese e mbarë publicistikës ishte e pamundshme, për arsye kohe, statistikat dhe të dhënat tona kanë gjithsesi një vlerë relative, e cila mund të kundërshtohet nga të dhënat e një vjeljeje të plotë.

I. Përsa i përket emrit, duhet shënuar se shqipja paraqet një larmi të madhe formash për mjaft kategori të tij. Në shqipen letrare të viteve të para të pasçlirimit, e bile edhe më vonë, hasen mjaft forma që pasqyrojnë ndryshimet dialektore ose luhatje e dyzime, të cilat, sidomos deri në atë periudhë ende nuk ishin kapërcyer e njëzuar nga zhvillimi i mëparshëm i gjuhës letrare. Edhe gjatë periudhës 25-vjeçare, relativisht të shkurtër, vërehen mjaft ndryshime, ku një sërë formash nga këto u njëzuan e u kristalizuan, ose, sëpaku, po priren drejt një njësimi e kristalizimi të tillë. Nga të gjitha çështjet që shtron ende emri, në këtë artikull do të trajtojmë vetëm problemin e ndërrimit të gjinisë, të formimit të shumësit, të formimit të rasave, të shquarjes dhe të fjalëformimit të emrave.

I. 1. Nga gjinia e emrave interes të veçantë paraqet luhatja e vazhdueshme që vërehet tek emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me mbaresën -e dhe -ra. Megjithëse norma gramatikore dhe mbizotëruese, në gjuhën e folur, në letërsinë artistike dhe në publicistikë, është ndërrimi i gjinisë në shumës, prapëseprapë edhe në publicistikë, si edhe në gjuhën e folur e në letërsinë artistike, haset rëndom ruajtja e gjinisë mashkullore. Një gjë e tillë vërehet sidomos tek emrat konkretë, por nuk mungojnë raste edhe nga emrat abstraktë. Kjo gjë vjen, sipas mendimit tonë, nga ndikimi i fortë që ushtron gjinia e njëjësit dhe përfytyrimi i ngulitur, qoftë edhe në mënyrë të pavetëdijshme, se ai emër i përket gjinisë mashkullore, pavarësisht nga numri. Ndonjëherë ruajtja e gjinisë mashkullore ka bazë dialektore; pra ndikon edhe dialekti, të cilit i përket shkruesi. Këtu hyjnë në radhë të parë këto fjalë: *shtete, vende, qytete, reparte, telegrame, organe, rrethe, fshatra, mallra*. Më rrallë kemi hasur edhe: *katunde, elemente, dyfeqe, suksese, kombe, limane, kontigjente, vapore, mure, detashmente, njësite, universitete, arkivole, portrete, çifligje, grupe, probleme, divizione, plane dajlane, mjete, kënde, sisteme, kurse, kanale, lloje, objekte, përfundime, kantiere, burime, shalle, kazane, pyje, fidane, stacione, vendime, rezultate, flamure, planete, materiale, laboratore, hangare, institucione, varietete, ambiente, mësim, ligje, minerale, harqe, drithra, shpirtra, plehra, shira e ujra*.

Ruajtje të gjinisë mashkullore gjejmë në të gjitha gazetat tona. Kështu p.sh. po të marrim vetëm vitet 67-68, shohim në *Zërin e popullit*: rretheve të tjerë, valse të bukur, kritereve më të mirë shkencorë, ekipazheve të ardhshëm etj.; në *Zërin e rinisë*: udhëtimet gjithmonë janë të rinj, vendeve paqëndrueshë, të njëjtët profesione, këta kalldrëme etj.; në *Mësuesi*: këta rrethe, rretheve të vegjël, probleme shumë të rëndësi-

shëm; në Puna: shpirtat fisnikë, objekte të rinj, shpërthime më të vegjël etj. Një numër relativisht më i madh përdorimesh pa ndryshim gjinie për emrat e këtij tipi vihet re në *Sportin popullor*: parqe të bukur sportivë, këndet sportivë, të gjithë repartet, kontinentet të tjerë, personalitete të tjerë të lartë, fenomenet sportivë, kampionatet e zhvilluar, ekipet shqiptarë etj.

Veçanërisht e domosdoshme është të mënjanohen kapërcimet nga gjinia në gjini brenda së njëjtës fjali a periudhë. Shfaqje të tilla, sado që nuk janë të rëndomta, nuk janë as aq të rralla, p.sh. vetëm para organeve supreme të sigurimit nga të cilët ata mvaren (ZP, 1948)⁷; flamurë të kuq dhe kombëtare (ZP, 1948); këto impiante të studjuar nga teknikët e vendit (ZP, 1949); të gjithë mësimet tona (ZP, 1952); u çelën kanale të rëndësishme vaditës (ZP, 1957); disa pyje të tjerë të degraduara (ZP, 1957); Nuk mund të ketë bashkëjetesë midis vendeve të shtypura dhe shtypës (ZP, 1960); nga qytetet më të mëdha e më të bukura (ZP, 1960); hyjnë e dalin mjete detare, të cilët shkarkojnë mallra (ZP, 1960); shumë numra të mrekullueshëm, në të cilat mbizotëronte fryma e papërkulur (ZP, 1965).

Një shfaqje tjetër është formimi i shumësit të disa emrave të këtij tipi jo me mbaresën -e (si zakonisht), por me mbaresën -ë ose -a e megjithatë, pikërisht nën ndikimin psikologjik të këtij shumësi në -e, ndryshohet gjinia nga mashkullorja në femërore (sikur ky shumës të formohet me mbaresën -e), p.sh. po i jep grushta të njëmbasnjëshme (ZP, 1942, 1948); argumentat e tua (ZP, 1942); argumenta të shëndosha/e të gjalla (ZP, 1942); elementat tradhëtare (ZP, 1949); elementa të cilat për anën e jugosllavëve nuk ishin të sakta (ZP, 1948); instrumentëve të ndryshme muzikore (ZP, 1958); elementët e parafabrikuara (ZP, 1960).

Nga ana tjetër shumë emrave u ndërrohet gjinia në numrin shumëës për arsye nga më të ndryshmet, p.sh. nga analogjia me fjalë sinonimike a forma paralele, të cilat i përkasin gjinisë femërore ose e formojnë shumësin me mbaresën -e, por edhe nga një tejshtirje e ndërrimit të gjinisë në disa emra që e formojnë shumësin me mbaresën -a etj. p.sh. artikuj ushqimore (ZP, 1949, 1958) (në analogji me sende); në këto vjetët e fundit (ZP, 1948) (në analogji me vite); aeroplanat spiune U-2 (ZP, 1960) (në analogji me plane); të gjitha krahët e punës (ZP, 1960) (në analogji me forcat); kulaçët e prera (ZP, 1960) (në analogji me kulaçe); lekë të reja (ZP, 1965) (në analogji me para); jetën e tij dhe të brezave të ardhshme (ZP, 1948); mitraloza të rënda (ZP, 1948); ka kënduar me theksa të prekëshme (ZP, 1948); motora të vjetra (ZP, 1948, 1949); parashikojnë të hapin edhe më shumë se 130 ha. të tjera (ZP, 1956); në rreshta të ngushta (ZP, 1956, 1960); tri herë më tepër drurë pyjore (ZP, 1957, 1958); të shehin edhe qindra kv. të tjera (ZP, 1957); më mirë 10 hektarë të plota se 20 hektarë për gjysmë (ZP, 1958, 1960); Atje ku prodhohen telat elektrike (ZP, 1965); tuba të shumëngjyrëshme (ZP, 1965).

Duke marrë parasysh faktin që në gjuhën e folur dhe në gjuhën e shkruar, pavarësisht nga shmangjet e herëpashershme, tek emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me -e, sidomos tek emrat abstraktë, është përgjithësuar ndërrimi i gjinisë në shumëës, ne mendojmë se është e drejtë këshilla e Ortografisë shqipe dhe e Rregullave të drejtshkrimit të

7) Për shkurtësi do të japim vetëm shkurtimin e titullit të gazetës dhe vitin e botimit të saj (pa datë e faqe): ZP = Zëri i popullit, ZR = Zëri i rinisë; P = Puna; SP = Sporti popullor; D = Drita.

shqipese⁸ që gjithë emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me mbare-sën -e, në këtë numër duhet të marrin përcaktorë të gjinisë femërore. E njëjta gjë vlen edhe për emrat që e formojnë shumësin me -ra, megjithëse tek ndonjë emër i veçuar vihet re një prirje në të mirë të ruajtjes së gjinisë mashkullore — emri *fshatra* vjetët e fundit po del pothuajse sistematikisht mashkullor. Gjithashtu janë për t'u mënjanuar si të dëmshme për gjuhën e përbashkët letrare tri shfaqjet e tjera që përmendëm; pra, nuk duhet lejuar as lëkundje gjinie në përcaktorët e ndryshëm të të njëjtit emër, as lëkundje gjinie gjatë një artikulli gazete për të njëjtin emër e as ndërrim gjinie për emra, shumësi i të cilëve nuk formohet me -e e -ra. Këtu bëjnë përjashtim disa emra të caktuar, shumësi i të cilëve është përgjithësuar me ndërrim gjinie, pavarësisht nga mbaresa e tyre, p.sh. *hapa, kolektiva, kuadro, eufemizma* (dhe gjithë të tjerët me -izëm), *trupa* etj.

2. Emrat asnjansë që tregojnë lëndë kanë kaluar përgjithësisht në gjininë mashkullore, por megjithatë aty-këtu edhe në publicistikë ka ende gjurmë të asnjansit të dikurshëm, p.sh. *Ujët* e Shkumbinit (ZP, 1958); me anë të tij *ujët* e Bistricës do të vaditë me mijra hektarë (ZP, 1956); *ujët* e përrrenjve... gërryente çdo gjë (ZP, 1956); *grurët* e parë në depot e shtetit (ZP, 1956) etj. Nga ana tjetër hasen raste, kur edhe në frazeologji këta emra përdoren si mashkullorë, p.sh. Por ka edhe rrethe që nuk e kanë vënë aq tepër *ujin* në zjarr (ZP, 1956). Me përjashtim të përdorimeve frazeologjike, këto lëkundje duhen mënjanuar në të mirë të gjinisë mashkullore. Gjërësisht përdoren emrat asnjansë nga mbiemrat prej-pjesorë të substantivuar, përkatësisht nga pjesoret, p.sh. e kupton se çdo të thotë të *mbledhurit* e buzëve (ZP, 1942); *t'ardhurit* në kontakt më afër me armiqtë (ZP, 1942); ka filluar të *ftohtit* (ZP, 1958); na priti me të *ftohtë* (ZP, 1958) etj. Kjo kategori asnjansish për arsye të njohura semantike nuk është gjithmonë e zëvendësueshme me emrat me prapashtesa të gjinisë mashkullore.

2. Një nga problemet më të ndërlikuara që paraqet sistemi emëror i shqipes është formimi i numrit shumësi. Ky paraqet një larmi të madhe formash dhe forma të shumta dublete si në gjuhën e folur⁹ ashtu dhe në gjuhën e shkruar. Le të shohim më parë shumësin e emrave të gjinisë mashkullore.

2.1. Shumësi i emrave mashkullorë.

Këtu është për t'u shënuar se qysh nga vitet e para të botimit të tij dhe deri nga vitet 50 në Zërin e popullit, shohim një mbizotërim të mbaresës -a të shumësit në dëm të mbaresave e, ë dhe të mbaresës zero. Megjithëse në gjuhën e folur mbaresa a është ende mjaft e gjallë,¹⁰ në

8) Ortografia e gjuhës shqipe, BUSHT, SShSh, 4, 1956, 52; Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt), Tiranë, 1967, 63.

9) Shih punimet e ndryshme dialektore.

10) Shih: J. Gjinari, *Verejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të Rrethit të Tropojës*, BUSHT, SShSh, 4/1963, 181; B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSHT, SShSh, 2/1963, 212; J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Krutës dhe të Malësisë së Krutës*, «Stud. fil.», 4/1964, 171; E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, «Stud. fil.», 3/1964, 119; B. Beci, *E folmja e Reç — e — Dardhës së Dibrës*, «Stud. fil.», 4/1964, 150; M. Totoni, *Vëzhgime për të folmen e Muzinës*, «Stud. fil.» 3/1965, 107; M. Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*, «Stud. fil.»

publicistikë përdorimi i saj erdhi duke u ngushtuar gjithmonë e më shumë në të mirë të mbaresës -ë, të mbaresës zero dhe pjesërisht të mbaresës -e. Kështu emrat që mbarojnë në -ent, -ist, -(ë)s, -or, -er, -l, -m etj. si p.sh. *element, student, agjent, komunist, shovinist, ballist, trockist, zgjedhës, mësonjës, nëpunës, drejtues, automobil, katil, kriminel, federal, shqelm, telegram, problem, aeroplan, kuising, mitroloz, traktor, revolver, oficer, toger* etj. deri në fund të vitit 1948 në publicistikë e formojnë shumësin pothuajse kryesisht me mbaresën -a. Deri në fund të 1948-s raporti midis mbaresave a: e: ë të shumësit të emrave të këtij tipi na del 14: 1.1: 1.7; mbaresa zero është edhe më e rrallë. Edhe në periudhën e viteve 1949-1952 mbaresa -a e shumësit është mjaft e gjallë, por megjithatë në këtë periudhë vihet re një gjallërim më i madh i mbaresës -ë të shumësit për këtë tip emrash; disa emra shkëputen përfundimisht nga mënyra e formimit të shumësit me -a dhe e formojnë me -e ose me ë; bëhet gjithmonë e më i shpeshtë shumësi me mbaresë zero. Raporti midis këtyre tri mbaresave (a:e:ë) në fund të kësaj periudhe, sipas materialit të shqyrtuar është 18,1:0.9:3.4. Nga emrat që nuk e formojnë më shumësin me mbaresën -a, por ndryshe, mund të përmendim: *probleme, gjokse, fidanë-fidanë, kantiere-kantierë, telegrame*, emrat e përveçëm, kur përdoren me kuptim të përgjithshëm (*Schumanët, Blumët*) etj. Pjesa tjetër e formon në të katër mënyrat, duke konkuruar midis tyre mbaresat a:ë e duke mbizotëruar ende mbaresa -a.

Për periudhën 1952-1956 ky raport ndryshon në mënyrë të ndjeshme në të mirë të mbaresës -ë e të mbaresës zero, dhe pastaj të -e-së. Shumësa të tipit *aeroplana, aksionista, artista, pistonë, traktora* etj. bëhen dalëngadalë më të rrallë. Në fund të vitit 1956 raporti a:e:ë na del 1:3, 5:4.7. Nga ana tjetër shumësi me mbaresë zero i emrave që mbarojnë në -(ë)s fillon të depërtojë gjithmonë e më shumë. Ndërkaq që në fund të kësaj periudhe nguliten disa shumësa me -a që përbëjnë normë edhe sot, p.sh. *dokumenta, frona, shefa, gola, filma* (dhe jo *filme*), *lapsa* (jo *lapse*), *tuba* (jo *tubo*), *viça* (jo *viçër*), *kilometra* (jo *kilometro*) etj.

Për periudhën dhjetëvjeçare 1957-1967 është karakteristike humbja graduale e gjallërisë së mbaresës -a të shumësit për këtë tip emrash dhe mbizotërimi i padiskutueshëm i mbaresës -ë e i mbaresës zero në dëm të së parës. Një ndihmë të madhe në thellimin dhe ngulitjen e kësaj prirjeje të vetvetishme të gjuhës letrare shqipe dhanë veçanërisht edhe Ortografia e gjuhës shqipe që u botua më 1956 dhe projekti i Rregullave të drejtshkrimit të shqipes, botuar më 1967. Që të dyja këto botime e mbështetnin plotësisht këtë prirje. ¹¹ Kështu megjithëse rrallë hasen shumësa të tillë: për riparimin e traktorave (ZP, 1957); uzinës së automobi-

4/1965, 103; K. Ulqini, *Disa vëzhgime mbi të folmen e Matit*, BUSHT, SShSh, 3/1961, 199; J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinës së Mallakastrës*, BUSHT, SShSh, 3/1962, 162; M. Çeliku, *Vërejtje mbi të folmen e Dumresë*, BUSHT, SShSh, 3/1963, 206; Q. Haxhihasani, *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*, BUSHT, SShSh, 4/1963, 127; J. Thomaj, *E folmja e katundit Seman*, BUSHT, SShSh, 3/1961, 175; J. Gjinari, *E folmja e Myzeqesë*, BUSHT, SShSh, 4/1958, 85; idem, *Mbi të folmet e Devollit*, BUSHT, SShSh, 4/1960, 113; idem, *E folmja e Beratit*, BUSHT, SShSh, 1/1957, 117; idem, *Një vështrim mbi të folmen e Oparit*, BUSHT, SShSh, 1(3)/1957, 141; idem, *E folmja e Skraparit*, BUSHT, SShSh, 1/1958, 92.

11) *Ortografia e gjuhës shqipe*, BUSHT, Tiranë, 1956/4, 50, 51; *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes*, (projekti), Tiranë, 1967, 19, 20, 63. Edhe ortografia e vitit 1951, nga A. Xhuvani — K. Cipo — E. Çabej, megjithëse nuk merr qëndrim drejtpërsëdrejti ndaj kësaj çështjeje, tek ruajtja ose jo e zanores -ë jep ndër të tjera edhe: *nëpunësisht, nëpunësvet* (f. 10).

lave (ZP, 1958); puna fizike e kuadrove drejtuese dhe nëpunsave (ZP, 1960); *solista* popullore (ZP, 1962, 1967); ulja e 12 *aeroplanave* ndjekës (ZP, 1962); grupe *aeroplanash* (ZP, 1967); nuk orientoi *mbrojtësat* (SP, 1967), *mundësat* (SP, 1967), *fiskulturistat*, *qitësat* (SP, 1967), *portiera*, *shitësa*, *kazana* (ZR, 1967), *dhuruesja* gjaku, *shitësa* (P. 1967) etj., prapëseprapë këta përsa i përket gjuhës së publicistikës në përgjithësi, mund të themi se janë shfaqje të veçara deridiku mbeturinore, kurse mbizotërues janë ose shumësat me -ë ose shumësat me mbaresë zero: *imperialistë*, *aksionistë*, *komunistë*, *agjentë*, *laburantë*, *ekskavatorë*, *traktorë*, *traktoristë*, *normistë*, *automobilë*, *aeroplanë*, *shoferë*, *oficerë*, *kompresorë*, *kursantë*, *diplomantë* etj.; *mundësit*, *mbrojtësit*, *pushtuesit*, *mësuesit*, *mjeshtërit*, *nëpunësit*, *zgjedhësit*, *rrrobaqepësit*, *përfaqësuesit* etj. Është për t'u theksuar se në «Sportin popullore» vërehet deridiku një farë ekuilibri midis mbaresës -a, nga njëra anë, dhe mbaresës -ë e mbaresës zero, nga ana tjetër. Vetëm për vitin 1967, sipas materialit të shqyrtuar, na del një raport i përafërt 2:2.6 në të mirë të grupit të dytë. Kështu këtu krahas *mbrojtësit*, *qitësit*, *ngritësit*, *fiskulturistët* etj. hasim mjaft shpesh edhe *mbrojtësat*, *mundësat*, *ngritësat*, *qitësat*, *fiskulturistat* etj.

Pothuajse ende barabar të përdorshëm (-a/-e, -a/-ë dhe -e/-ë) janë shumësat e disa emrave të veçantë si *xhama-xhame*, *xhepa-xhepe*, *automobilë-automobila*, *kamionë-kamiona*, *fidane-fidanë*, *grafike-grafikë*, *kantiere-kantierë*, *korridore-korridorë*, *lapidare-lapidarë*, *dollape-dollapë*, *hangare-hangarë*, *çitjane-çitjanë*, *seminare-seminarë*, *tavane-tavanë*, *ballkone-ballkonë*, *rezervuare-rezervuarë* etj.

Nga ana tjetër janë ngulitur format e shumësit në -e për emra të tillë si *dyqane*, *supe*, *hidrocentrale*, *territore*, *monumente*, *mëngjeze*, *batalione* etj. Për disa nga këta emra vërehen shmangje të pakta në të mirë të mbaresës -ë, të cilat mendojmë se duhen mënjanuar në të mirë të mbaresës së përgjithësuar -e. Me -e e bën shumësin shumë herë edhe ndonjë emër i gurrës turke (veçanërisht ata në -llëk): *oxhake* më të mëdhenj (ZP, 1956, 1966); trajtohej si monedhë çkëmbimi në *parzarllëket* e fuqive imperialiste (ZP, 1956, 1966, 1967); *tarafllëket* e ambiciet personale (ZP, 1956); prapa ka *boshllëke* e të meta (ZP, 1966).

Si përfundim, na del se në gjendjen e sotme emrat që mbarojnë në: -ist, -ak, -az, -ant, -tar, -at, -ot, -al, -ek, -it, -ier(ër), -ik, -el, -os, -oz, -uz, -ur (pavarësisht nëse këta tinguj përbëjnë prapashtesë, apo janë thjesht tinguj fundorë të temës) e formojnë shumësin me mbaresën -ë; ata që mbarojnë me -al, -an, -ar, -ent e formojnë me -ë dhe me -e: *fidanë*, *legalë*, *rezervuarë*, *hangarë*, *studentë*, *agjentë*, *elementë*, krahas *fidane*, *kambiale*, *rezervuare hangare*, *monumente*, *asortimente* etj.; ata që mbarojnë në -on, -il, -iç e formojnë edhe me -ë edhe -a (*kamionë*, *automobilë*, *çekiçë*, *kamiona*, *automobila*, *viça* etj.); ndërsa ata që mbarojnë në -(ë)s (me ndonjë përjashtim, si p.sh. *çelësa*) e formojnë shumësin me mbaresë zero, d.m.th. njëjësi i tyre nuk ndryshon nga shumësi.

Për mbaresën -a, përveç emrave që mbarojnë në -iv, nuk mund të hetojmë ndonjë rregullësi — kështu emrat *kollektiv*, *objektiv*, *arkiv* zakonisht e formojnë shumësin me -a, megjithatë: *aktivet* e partisë (gjithandëj në publicistikë).

Për shumësin *veta* apo *vetë* na del një raport 1:2 në të mirë të mbaresës -ë. Diferencimi i shumësit të emrit *fryt-i* në dy forma të ndryshme: *fryta* e *fryte*, ka arësye semantike (*fryta*-pemë, *fryte*-fitim, dobi). Në gjuhën e shtypit shumësi i emrit *vagon-i* është më i rëndomtë me -ë se me -a (*vagonë* më shpesh se *vagona*). Disa nga emrat që tregojnë

jo

jo

+trub. Kur duket mundon e ?

shpesh supra

shumësi me -ra (sh.)

njësi matëse (*dynym, hektar, kuinal*) e formojnë shumësin pa asnjë përjashtim me *-ë*, kurse për *ton-i*, përkundrazi, mbizotëron shumësi i pandryshueshëm; edhe *kilogram* haset vetëm i pandryshuar. Shumësi i emrit *flamur-i* po përgjithësohet me *-ë* (si shmangje haset relativisht shpesh shumësi me *-e*: *flamure*, kurse shumësi *flamuj* është bërë mjaft i rrallë). Emri *vit-i* e formon shumësin dy mënyrësh (duke përjashtuar këtu luhatjet jo të rëndomta *vjetet*): me mbaresën *-e*: *vite*, ose *vjet*. Forma e parë, megjithëse nga viti në vit po gjen një përhapje sa vjen e më të gjerë, nuk është në gjendje të përjashtojë formën e dytë — në bashkë-vajtje me numra, pa u shoqëruar me përcaktorë të tjerë, ky emër e formon shumësin vetëm sipas mënyrës së dytë, përndryshe hasen të dy mundësitë. Kështu thuhet vetëm: Kanë kaluar pesë *vjet* (ZP, 1956); kanë kaluar 17 *vjet* (ZP, 1956); pas dhjetë *vjetëve* (ZP, 1956); gjatë 20 *vjetëve* (ZP, 1964); 10 *vjet* kanë kaluar (ZP, 1957); 40 *vjet* të jetës sime (ZP, 1959); tre *vjet* (ZP, 1958); 10-12 *vjet* më parë (ZP, 1960); 44 *vjet* më parë (ZP, 1964) etj. Por, nga ana tjetër, mund të thuhet edhe: eksperiencia e *viteve* të kaluara (ZP, 1957); gjatë *viteve* të mëparëshme (ZP, 1958); më mirë se *vitet* e tjera (ZP, 1958); *vitet* e fundit (ZP, 1959); gjatë *viteve* të pesëvjeçarit (ZP, 1962); gjatë këtyre *viteve* (ZP, 1965) etj. dhe: eksperiencën e *vjetëve* të fundit (ZP, 1956); gjatë këtyre *vjetëve* të ndërtimit socialist (ZP, 1957); gjatë *vjetëve* të pushtetit popullor (ZP, 1958); Në *vjetet* e parë pas çlirimit (ZP, 1965); *vjetet* e fundit (ZP, 1966) etj.

Emrat që e formojnë shumësin me mbaresën *-(e)nj* ose *(e)j* dhe *(i)nj* a *(i)j* e ruajnë tingullin *-nj* pothuajse gjithandej, kjo përbën normë. Nga materiali i shqyrtuar që nga 1942 e sot kemi gjetur vetëm 4 raste me *-j*, kurse në të gjitha rastet e tjera kemi *-nj*, p.sh. *përrenj, lëmenj, shkëmbenj, lumenj, heronj, ullinj, mullinj, mullixhinj, të rinj, suvaxhinj, gishtrinj, kallinj, barinj, drunj* (edhe *drurë*), *shkopinj, ftonj, pirunj, liretaxhinj, breshkaxhinj, çiliminj, skraparllinj, thonj* etj. Nga ana tjetër shumësi i emrit *kufi-ri* del gjithmonë *kufij*, po ashtu ai i emrit *kalaman-i; kalama-j*, kurse shumësi i emrit *liqen* del në tri variante: *liqej, liqenj, liqene*. Dy emrat e parë do të ishte më e këshillueshme të bashkoheshin me grupin përkatës në *-nj*, për t'iu shtëmangur përjashtimeve, kurse emri i fundit është më e drejtë ta formojë shumësin me *-e*.

Me mbaresën *-ra* hasim kryesisht vetëm shumësa të llojit (*mallra, drithra, vajra, barëra, misra* etj.) por edhe *fshatra* e më rrallë *detra* (që konkuron me *dete*). Është për t'u shënuar se, kur emri mbaron me bashkëtingëlloren *-r*, atëhere më shpesh se sa të shtohet një *-ë* midis saj dhe mbaresës *-ra*, parapëlqehet forma e parotacizuar e bashkëtingëllores së mbaresës: *-na*, p.sh. *liqerna* (edhe *liqerëra* — ZP, 1956), *barna* (edhe *barëra* — ZP, 1957, 1958), *yndyrna* etj.

Mbaresa *-ër* në fillim na del më e gjallë, pastaj, dalëngadalë prodhueshmëria e saj vjen e rrudhet në të mirë të mbaresës *-ë*. Kështu, në fillim hasim: *greqërit* e vjetër (ZP, 1942); *bujqërit* tonë (ZP, 1942); kemi *Qemalër* e *Perlatër*, kemi *Kushër* e të tjerë (ZP, 1942); *Musolinërit* (ZP, 1942); *Ujqërit* imperialista (ZP, 1943); *Përlat Rexhepërve* (ZP, 1943); *Tetëdhjetë qenër* armiq (ZP, 1943), dhe krahas tyre gjaku i *Qemalëve*, *Vojo Kushëve* e *Sadik Stavalecëve* (ZP, 1943); me gjakun e *Qemalëve*, të *Vojovë* (ZP, 1943); *Jakomonët* (ZP, 1942). Sot kjo mbaresë formon shumësa të tillë: *prindër* (që mbizotëron ndaj *prindë*); *zotër, robër*, (që konkuron me *robë*), *skillevër* (që mbizotëron ndaj *skllavë*), *stërgjyshër, gjy-shër* (që konkuron me *stërgjyshë* e *gjyshë*), *labër* etj.

Me shumës në -o, ashtu si në gjuhën e folur dhe në mbarë letërsinë artistike, dalin: *kuadër-kuadro, teatër-teatro*¹². Ndërkaq duhen mënjanuar shumësat mjaft të përhapur: *kilometro, metro* në të mirë të *kilometra, metra*.

2.2. Shumësi i emrave femërorë

Shumësi i emrave të gjinisë femërore paraqet më pak ndërlikime. Në vitet e para mjaft emra femërorë, e në radhë të parë ata që mbaronin në një zanore të theksuar, e formonin shumësin e tyre shumë shpesh me mbaresën -ra: *hazinera* (ZP, 1942); *kohëra* (ZP, 1942, 1948, 1950); *vështirësira, thellësira, shtëpëira, anomalira, sasira* (ZP, 1949); *ekonomira, njësi-ra* (ZP, 1948, 1951); *idera, mrekullira, mundësira* (ZP, 1948) etj. Megjithëse në publicistikën e ditëve tona mbizotërues është shumësi me mbaresë zero për këta emra, prapëseprapë shfaqje të formës me -ra gjejmë pothuajse çdo vit, p.sh. *akrobacira, mundësira* (ZP, 1956); *trashera* (ZP, 1958); *cilësira, hollësira, sasira* (ZP, 1963); *shtëpëira* (ZR, 1967); *tragjedira* (ZP, 1969). Ne mendojmë se në përgjithësi, në përdorimin e tyre neutral, për emrat e këtij tipi është përgjithësuar me të drejtë shumësi me mbaresë zero (pra: *anomali, ekonomi, thellësi, vështirësi* etj.). Por me ngarkesë emocionale, kryesisht pejorative, pikërisht nën ndikimin e shumësit të llojit, ruhet, dhe duhet të ruhet, shumësi me -ra,¹³ p.sh.. Prandaj as kafene nuk duhet të hapim shumë, por në radhë të parë është e nevojshme të punojmë për edukimin e njerëzve, pse në rast se nuk bëhet kjo që është e para, të tillë njerëz të paedukuar medoemos do t'i zhvillojnë gjetkë veset e tyre të këqia, ata do të invadojnë institucionet tona kulturore që nuk quhet kafene, por që lehtë mund të kthehen në kafenera. (E. Hoxha: Të vazhdojmë me këmbëngulje dhe në mënyrë metodike edukimin e gjithanshëm të klasës punëtore. Tiranë, 1969, 20). Ndërkaq mbaresa -ra e shumësit ka zënë vend të qëndrueshëm tek emrat e llojit, si *lojra* (krahas *lojna*), *erëra, luftra, tagjira, bojra, verëra, farëra*, (krahas *farna*) e ndonjë tjetër.

Nga shumësi me mbaresën -a mund të përmenden ndër të tjera këto raste: *kontrata, rroba, helmeta, çesma, arra, kaldaja, banja, mënyra*, të cilat duhen përgjithësuar në dëm të: *kontrato, rrobe, çesme, helmete, arrë, kaldajë, banjo, mënyrë*. Nga ana tjetër më të përgjithësuar na dalin shumësat: *këmishë, dardhë, pjeshkë, lëkurë, gozhdë, gjurmë, degë, gjymtyrë, mollë* se sa *këmisha, dardha, pjeshka, lëkura, gozhda, gjurma, dega*.

Emri *pikë-a* njihet dy shumësa me diferencime semantike midis tyre. Ndërsa në terminologjinë sportive është përgjithësuar shumësi i pandryshuar *pikë*, në të gjitha fushat e tjera të përdorimit ky emër ka një shumës të përbashkët *pika*, p.sh. veç *pikave* të rendit të ditës (ZP, 1963);

12) Këtu nuk duhen përzier emrat me temë në -o, të cilët e kanë shumësin të njëlojtë me njëjës, p.sh. *palaco, laro, balo* etj.

Megjithëse ky shumës është kundër natyrës së shqipes, prapëseprapë është i vetmi për këto fjalë. Formën me -a (*kuadra, teatra*) që këshillon Fjalori i gjuhës shqipe i 1954-s dhe Fjalori i terminologjisë tekniko-shkencore (Terminologjia e letërsisë, Terminologjia e minierave), 1964, 1965, e gjejmë jashtëzakonisht rrallë (jo më tepër se 3-4 raste gjithësejt).

13) Komisioni i Rregullave të drejtshkrimit të shqipes (projekt), Tiranë, 1967, 63, shprehet në të mirë të shumësit pa mbaresë, pa bërë ndonjë dallim midis përdorimit neutral, ngarkesës emocionale dhe shumësive të llojit.

Është një gjë normale që ju dhe ne të mos jemi dakord për disa *pika* (ZP, 1964); për *pikat* e fundit të gjakut (ZP, 1942) etj.; nga ana tjetër kemi: «Partizani» shënoi disa *pikë* (ZP, 1962); duke patur 23 *pikë* (ZP, 1964); ekipet e Tepelenës, Sarandës dhe Përmetit grumbulluan *pikë* të barabarta (SP, 1967) etj. Arësye semantike ka edhe diferencimi *urë* zjarri dhe *ura* rrugësh.

Nga shumësat e pandryshueshëm, përveç emrave që përmendëm më lart, vlen të përmenden edhe emrat që mbarojnë në *-e* dhe emrat që mbarojnë në *-o*: *shkrepse, bajame, farishte, akacje, përparëse* etj.; *byro, bazho, torno, depo, gusto, pako, rimorkio, trapano*, etj.

3. Nga kategoria gramatikore e rasës po shqyrtojmë vetëm rasën kallëzore dhe rasën rrjedhore, të cilat mendojmë se paraqesin interes të veçantë.

3.1. Për rasën kallëzore një problem me rëndësi përbën forma e emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë në zanore të theksuar. Këtu mund të dallohen dy grupe: a) emrat që mbarojnë në zanoren *-a*: *baba, aga, vëlla, Mustafa, fukara* etj. dhe b) emrat që mbarojnë në *-i, -e* e *-y* të theksuar, p.sh. *njeri, mi, ari, kalemxhi, lekaxhi, hanxhi, Ali, fajdexhi*, mbiemrat e substantivuar të tipit: *i ri, i zi; atdhe, dhe, muze, jubile, mëmëdhe, Skënderbe, sy* etj.

Për tipin e emrave të grupit të parë na del mbizotëruese dhe mendojmë se mund të përgjithësohet shtimi i nyjës temës së kallëzores, p.sh. të pyesim *Mustafanë* (ZP, 1942); *Mustafanë* e ka kapur (ZP, 1942); plagoste patriotin, *vëllanë* e tija (ZP, 1942); me të *vëllanë* (B, 1969); Partia ish me *fukaranë* (ZP, 1949) etj.

Nga ana tjetër, për tipin e grupit të dytë, ndërsa për periudhën e parë vihen re mjaft luhatje, të cilat rrallë herë ndeshen edhe sot, në ditët tona mbizotëron shtimi i nyjës *-në* një temë analogjike me emëroreñ, p.sh. sa për zemër e ideal mos kërkò në *kalemxhinë* (ZP, 1942); Eqrem Beu me Hilmi Benë (*Lekaxhinë*) (ZP 1943); donin *atdhenë* (ZP, 1943); i bënë hesapet pa *hanxhinë* (ZP, 1943); më tha duke më mbyllur në të majtë *Tekin* me *Alinë* (ZP, 1943); për *fajdexhinë* (ZP, 1942); Çau oqeanin Atlantik e *Mesdhenë* (ZP, 1942) — dhe, nga ana tjetër më rëndom: me *Skënderbeun* luftoi një çerek shekulli (ZP, 1943); për të mbrojtur *atdheun* (ZP, 1942); me njeriun më të dashur (1948); të vlefshëm për *atdheun* (1948, 1949, 1950, 1952, 1956, 1960, 1964, B, 1969); *njeriun* e ri (ZP, 1959, 1964, B. 1969); së bashku me të *riun* Vasil Agora (B. 1969); duke parë me *syrin* kritik (B. 1969); nisi në fshat *turneun* e saj të tretë (ZP, 1956); grumbullojnë *dheun* (ZP, 1957, 1959, 1964); kishte nxjerrë *kallirin* (Z.P. 1958); me gjithë kohën e keqe dhe *shiun* (ZP, 1956); në *jubileun* e madh (ZP, 1964); *Ruzhdiun* (ZP, 1965) etj.

Ne mendojmë se për grupin e dytë është i drejtë përgjithësimi i formës me temë analogjike; megjithatë për përdorime frazeologjike edhe këtu mund të përdoren disa forma popullore¹⁴ me një temë kallëzore jo analogjike, p.sh. nuk ha njeriu *njerinë* (ZP, 1942); na ruan si macja *minë* (ZP, 1942); si arixhiu *arinë* (ZP, 1942).

3. 2. Një dukuri interesante që vërehet për rasën rrjedhore është denduria shumë e madhe e përdorimit të shumësit të pashquar në *-sh*. Është e vërtetë që ajo haset në të gjitha funksionet e saj edhe në letërsinë artistike, por denduria e përdorimit të tyre në publicistikë na del shumë më e

14) Në gjuhën e folur hasen që të dyja format, por, sidomos në variantin verior, mbizotëron forma me temë analogjike.

madhe se në letërsinë artistike¹⁵, p.sh. fushatë abonimesh; maqinë zogjsh; seri objektesh, mungesë mjetesh; metoda e drejtimit burokratik. . . prej mehmurësh; një sasi automjetesh; varg suksesesh (angazhimesh); një sipërfaqe prej 139 hektarësh; zëri i miliona e miliona njerëzish; kopshte fëmi-jësh; seri angazhimesh (veprash, hallesh); s'janë veçse pallavra e hi sysh; një tok faktesh; një delegacion gazetarësh; përmbledhje tregimesh; një mori e tërë kujtimesh; një sërë incidentesh; me anë konsultash; mbledhjes etj.; para disa ditësh; një grup shokësh; valë protestash; lloj-lloj ngjyrash; pas ca kohësh; me shumicë votash; janë para detyrash të mëdha; mbledhja prej dy ditësh etj. etj. Ne mendojmë se kjo veçori shpjegohet me vetë stilin publicistik.

Me përemra vetorë të v.I e v.II, ashtu si në gjithë gjuhën letrare, haset vetëm kjo formë e shumësit: para nesh; para jush; përkrah nesh; ndaj nesh; midis nesh; ndaj jush; secilit prej nesh; nëpërmjet jush; kundër nesh; pranë nesh, afër jush; përpara nesh; kurse me përemra të tjerë hasim edhe shumësin me -sh dhe shumësin me -ve, p.sh. ndërmjet të tjerash (ZP, 1949, 1958); para së gjithash (ZP, 1952, 1959); dhjetra prej syresh (ZP, 1952); midis tjerash (ZP, 1949); në mes të tjerash (ZP, 1960) etj.; përveç të tjerave (ZP, 1956, 1957, 1958, 1963); ndërmjet të tjerave (ZP, 1957); ndërmjet tyre; disa prej tyre (ZP, 1966); midis tyre (ZP, 1958) (tre përdorimet e fundit përbëjnë normë); midis të tjerave (ZP, 1950, 1960, 1966); krahas të tjerave (ZP, 1963) etj.

Kalimi nga forma me -sh e rrjedhore shumës në formën me -ve është një fenomen më i rëndomtë tek emrat. Këtu mund të kemi të bëjmë me një përdorim të kushtëzuar të formës me -ve (kur folësi e përdor emrin e dhënë kuptimisht të shquar, por mund të kemi të bëjmë edhe me një sinonimi të thjeshtë morfologjike, p.sh. Para pak ditve në qytetin e Korçës (ZP, 1949); të dy palët mundohen t'i hedhin hi syve popullit (ZP, 1942); duke e kryer në këtë mënyrë brenda dy ditve vendosjen e binarëve (ZP, 1949-1952); Para disa kohëve në të gjitha organizatat bazë të qytetit tonë u punue letra e KQ (ZP, 1949, 1959, 1960); pas disa ditve (ZP, 1949); brenda pesë vjetëve ka ndryshuar që nga rrënjët (ZP, 1956); i përfundoi ato para disa muajve (ZP, 1956); Vetëm gjatë 20 ditve u prodhuan (ZP, 1957); gjatë 9 ditëve u bënë 374 ml. (ZP, 1958); brenda tri katër ditëve (ZP, 1958); Midis qindra punonjësve të qytetit ndodhen në çfaqje edhe. . . (ZP, 1958); gjatë dhjetë muajve këtu janë siguruar (ZP, 1959); brenda disa ditëve (ZP, 1960); dallohen për prodhimin e një sërë artikujve të rinj (ZP, 1963); ndaj rezolutave të OKB-së dhe të një sërë organizatave të tjera (ZP, 1964) etj.

Ne mendojmë se, kur emri përdoret kuptimisht i pashquar, siç janë pjesa më e madhe e shembujve të mësipërm, është më e këshillueshme të ruhet forma me -sh e rrjedhore, për më tepër kur forma me -ve formalisht nuk dallohet fare kur tregon një shumës të pashquar e kur një të shquar. Nga sa u parashtrua, del se, kur kemi të bëjmë me rrjedhore përcaktore pa parafjalë përdoret vetëm forma me -sh, ndërsa, kur kemi të bëjmë me rrjedhore me parafjalë mbizotëron forma me -sh, por jo aq rrallë haset edhe forma me -ve.

Shënim: Duhet mënjanuar përdorimi: para disa kohe (ZP, 1960); janë realizuar prej kohe (ZP, 1952, 1956, 1960); brenda pak kohe do të kthehet në shtëpi (ZP, 1959) etj.

15) Mund të lexosh një roman të tërë dhe të tërë gjuhë aq raste rrjedhoreje me -sh sa në disa numra gazete.

Tek emrat hasen edhe kapërcime nga forma e rrjedhore në atë të kalëzores, e bile një pjesë e mirë e këtyre është përgjithësuar, sepse në përgjithësi në gjuhë parapëlqehet më tepër një formë e pandryshueshme, se sa një formë rasore me mbaresa, p.sh. të tregonte se çfarë ndjenja të çuditëshme provoi (ZP, 1958); u plotësua plani prej 54.500 rrënjë (ZP, 1965); duke kryer një volum pune prej 100.000 lekë (ZP, 1966); prodhimi i transformatorëve të fuqishëm prej 220 mijë volt (ZP, 1964), turni i parë i vullnetarëve i përbërë prej 2300 vetë (ZP, 1969); do të prodhojë një seri artikuj të rinj (ZP, 1956) etj.

Janë për t'u mënjeluar shmangjet që vihen re në formimin gjindore-rrjedhore njëjës të emrave që mbarojnë në -je. Megjithëse mbizotëruese është forma mbledhjeje, ndërmarrjeje, pyetjeje etj., jo rrallë hasen përdorime të tilla: vazhdojnë t'i vijjnë telegrame përshtëndetje (ZP, 1949, 1950); 15 kantiere të kësaj ndërmarrje (ZP, 1948, 1949, 1956, 1962, 1964); kësaj pyetje i përgjigjet historia (ZP, 1949, 1963.); në studimet e kësaj përmbledhje (ZP, 1964); Kjo u arrit pas një pune të gjatë dhe pas një pregatitje me të vërtetë serioze (ZP, 1963); në punimet e kësaj mbledhje, përveç shkrimtarëve dhe letrarëve të rinj (D, 1967); me fondet e tyre të ngrënë ambulanca, sidomos shtëpi lindje (B, 1967); në materialet e një mbrëmje përkujtimore (D, 1967); Në jubileun e kësaj ngjarje (P, 1967); i vunë zjarrin një anije ushtarake (ZP, 1968); ta quajnë aksionin e rinisë shkollë të madhe kalitje dhe edukimi (ZR, 1967).

4. Nga shquarja e emrave do shënuar se deri nga viti 1952 tek emrat femërorë që mbaronin në -i të theksuar, kur shquheshin, midis temës dhe nyjës shquese -a ndërhynte tingulli antihiatizues -j-; demagogjija, skllavërija, tregëtija, rinija, partija, tradhëtija etj. Megjithatë, duhet thënë se, megjithë mbizotërimin e kësaj mënyre shquarjeje, prapësëprapë, qysh më 1942 kemi edhe raste shquarjeje pa tingull antihiatizues. Kjo dukuri e fundit erdhi duke u përhapur dhe sot hasim vetëm raste jashtëzakonisht të rralla, ku mënyra e parë ruhet ende, p.sh. Ministria e Bujqësisë (ZP, 1956); shtëpija, ushtria (ZP, 1956), partija (ZP, 1959); zhurija (ZP, 1960); cilësia e prodhimit (ZP, 1964), kurse mbizotëruese dhe gjithandej të përgjithësuar janë: shtëpia, cilësia, ministra etj.

E ndryshuar paraqitet edhe shquarja e emrave në shumës: ndërsa në periudhën e parë, sidomos 1942-1948 kemi mbizotërim të trajtës së shquar me ruajtje të nyjës shquese -t-: çlirimit të popujvet, armatavet, armiqvet, malevet, shqiptarëvet, forcavet etj., dalëngadalë erdhi e fitoi trajta pa nyjë shquese të ruajtur, e cila në fazën e parë përdorej më rrallë, në raport me të parën. Pas 1953-1954 përdorimi i trajtës me nyjën -t fillon e kalon në shmangje në raport me trajtën e përgjithësuar pa -t dhe sot, ashtu si në gjithë gjuhën letrare, haset jashtëzakonisht rrallë në publicistikë.

Një problem që qëndron edhe sot i pazgjidhur përfundimisht, ose më mirë që njeh dy zgjidhje, është shquarja e disa emrave të gjinisë femërore ose mashkullore që mbarojnë hë o të patheksuar, p.sh. gestapo, Nako, Shanto, Kristo, moto, radio, Tito, depo, kuraço, çimento, Koço, Milano, Kastro, NATO, Tokjo, xhiro, gusto etj. Të gjithë emrat e këtij tipi i hasim të shquar herë duke dalë në togun zanor në -ua (gestapua, Nakua, Shantua, Kristua, motua, radiaua, kostua etj.) e herë duke e ruajtur -o-në fundore, por duke marrë një -j- antihiatizuese midis temës e nyjës shquese (gestapoja, Nakoja, Shantoja, Kristoja, motoja, radioja). Nga materiali i shqyrtuar del se të dy mënyrat janë mjaft të përhapura. Në gjuhën letrare dhe në gjuhën e folur është e njëjta gjëndje — në të folmet e lehtë është më e përhapur shquarja në -ua, kurse në variantin

verior vetëm shquarja në -o. Po pavarësisht nga shkalla e përdorimit të të dy mënyrave të shquarjes, mendojmë se, për hir të ruajtjes së temës dhe meqë shpeshherë kemi të bëjmë edhe me emra të përveçëm (bile herë-herë të huaj), do të ishte më e këshillueshme të përdorej vetëm trajta me ruajtje të o-së, e cila mund të përhapet më lehtë në mbarë shqipen sesa trajta me -ua.¹⁶

Një problem tjetër është ai i shquarjes së disa emrave të huaj në rasën emërore e ndonjëherë edhe gjindore. Këta emra shpeshherë nuk shquhen në rasën emërore, p.sh. *radio* lokale e kantierit të Kuçovës jep çdo mbrëmje emision (ZP, 1949); Mesazh i Wilhelm Pieck drejtuar popullit gjerman (ZP, 1950); asistonte *Ministër* i shëndetësisë (ZP, 1948); Deklaron *Sukarno*; *Sukarno* deklaroi (ZP, 1960, 1963); u dënua nga Raul Kastro (ZP, 1964) etj. Mendojmë se një mënyrë e tillë përdorimi është për t'u mënjanuar nga gjuha letrare.

5. Nga fusha e fjalëformimit të emrave është për t'u shënuar, sidomos për vitet e para, por jo aq rrallë edhe për ditët tona, moskuptimi i strukturës fjalëformuese të mjaft fjalëve të prejardhura. Megjithëse gramatikisht trajtohen si një fjalë e vetme, fjalët e reja nuk kuptohen si fjalë kualitativisht të ndryshme nga fjala a fjalët prodhuese, por përkundrazi, elementët përbërës të tyre nuk ndjehen të bashkëshkrirë, por të mëvetësishëm. Kjo arësyje na bën të mendojmë se këtu nuk kemi të bëjmë me një gabim thjesht drejtshkrimor, por me një gabim që lidhet me moskuptimin e drejtë të strukturës fjalëformuese të fjalëve. Një gjë e tillë vihet re në fjalët e formuara me anë parashtesash dhe në kompozitat përcaktore, p.sh. *bashkë tradhëtarit, bashkë fjalimet, mos dëgjesën, mos besim, mos njohje, nën reparte, pa dije, prodhimit të para luftës, pas luftës; larg breg detit, pa kokë dhëmbje*, e udhëhequr prej zemër *luanit*, në minierën e *qymyr gurit*, në fushat e *panxhar sheqerit, lule diellit*¹⁷ etj.

Për fjalëformimin e emrave me prapashtesa vlen të përmendet formimi me anë të prapashtesës -(ë)s. Ndërsa në periudhën e parë si temë prodhuese për emrat e vepruesit që formohen nga temat foljore në -o me anë të kësaj prapashtese, përdoret veta e parë e kohës së tashme të mënyrës dëftore të foljeve, në formën e saj dialektore në -nj, që nga vitet 1952-1955 e këtej fillon zëvendësimi i saj pothuajse i plotë me pjesoren e dialektit verior në -ue. Shfaqjet e variantit të parë në publicistikën e ditëve të sotme janë mjaft sporadike. Kështu, ndërsa deri në vitin 1952 krahas emrave të tipit: *mësues, përfaqësues, sulmues* etj. hasim si mbizotëruese format: *mësonjës* i math, *pasonjës* i denjë, *sundonjësit, themelonjësit, përfaqësonjësit, sulmonjësve, krijonjësi* dhe *frymëzonjësi* i planeve pesëvjeçare; *komentonjësi* i mirënjohur *prodhonjësit, hartonjësit, drejtonjës* fushe, *pretendonjësit* etj., që nga viti 1955 e këtej ka mbetur vetëm një emër që i përmbahet sistematikisht këtij tipi të fjalëformimit: *punonjës*, kurse për emra të tjerë ky tip haset shumë rrallë si shmangje. Nga materiali i shqyrtuar për vitet '56-'67 na dalin gjithësejt vetëm nëntë shembuj të tipit të parë (*çponjës, kultivonjës, qendërsulmonjës* etj.). Siç del nga sa parashtruam, gjëndja e kësaj duku-

16) *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes* (projekt), Tiranë, 1967, 40, i japin që të dyja format si norma variante, duke parapëlqyer si rend ruajtjen e o-së fundore.

17) Për rrugën e fjalëformimit të tipit të tri fjalëve të fundit shih hollësisht: A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*. BUSHT SShSh, 1961, 10 v.

fjalëformimi
kompoziti
prapashtesave
shumëvjeçare

rie gjuhësore në publicistikë është e ndryshme nga ajo e letërsisë artistike.

Mjaft karakteristike për gjuhën e publicistikës janë edhe disa kompozita kopulative që vijnë nga pranëvënja e dy fjalëve, p.sh. puntorët e ngarkim-çarkimit (ZP, 1952); brigadën e çim-shfrytëzimit, në ndërmarrjen e përparuar të çimshfrytëzimit (ZP, 1957, 1964); janë të zënë me fushatën e korrije-shirjeve (ZP, 1957); punonjësit e ndërmarrjes së çim-kërkimeve (ZP, 1958); hotel-restauranti (ZP, 1958); mirëmbajtjes së rrugë-urave (ZP, 1966).

Krahas kompozitave të njohura determinative (përcaktore) vërehen edhe disa kompozita të tilla më të reja të cilat, sadoqë ndonjëra prej tyre edhe mund të përligjet, ne mendojmë se është më mirë të zvendësohen me togje, elementi i dytë i të cilave të jetë në rasën rrjedhore prkt. në gjindore p.sh. uzina e madhe e pjesë-këmbimit «Enver» (ZP, 1948) (në vend të: e pjesëve të këmbimit a për këmbim); Në kantierin e ndërtes banimit (ZP, 1949) (në vend të: ndërtesave të banimit); Edhe kooperativa e punim-drurit (ZP, 1956) dhe kooperativave të punimdrurit (në vend të: punimit të drurit); Punonjësit e fabrikës së tekstil leshit (ZP, 1956) etj. Fjalë të tilla, me sa duket, janë formime sintaksore që vijnë nga togjet ndërtesë banimi, punim druri, pjesë këmbimi etj.

II. Përsa i përket normës gjuhësore të nyjës së përparme nuk ka probleme teorike të pazgjidhura. Këtu kemi një normë të qartë për të gjitha aspektet e përdorimit¹⁸, por duhet thënë se në zbatimin praktik të kësaj norme haset një numër jo i vogël shmangjesh, të cilat mund të përfshihen në dy grupe kryesore: mospërshtatja e drejtë në gjini dhe mospërshtatja e rregullt në numër. Dihet se nyja mund të vijë drejtpërsëdrejti pas emrit përkatës, ose midis saj dhe emrit të dhënë mund të ndërfitet një mbiemër ose një a disa pjesë të tjera ligjërata kryesisht emra e mbiemra, por s'përjashtohen edhe të tjera. Le të shikojmë konkretisht këto shmangje duke i ndarë në këto grupe: 1) emër mashkullor (prkt. femëror) + nyjë e përparme, 2) emër mashkullor (prkt. femëror) + mbiemër + nyjë e përparme, 3) emër mashkullor (prkt. femëror) + emër (a më se një pjesë ligjërata) + nyjë të përparme dhe 4) emër në gjindore + emër femëror të paranyjësuar.

1) Dihet se nyja e përparme për nga ana formale përshtatet me emrin prirës (p.sh. ansambli i klasës punëtore (ZP, 1969), rinia e revolucionit (ZP, 1969). Në zbatimin praktik të kësaj norme, që është mbizotëruese në mbarë shqipen letrare, vërehen këto shkarje: a) mungesa e nyjës së përparme pas një emri në gjindore-dhanore, p.sh. populli i qytetit Beratit (ZP, 1948); Komiteti Skraparit; problemi kooperativave; rrethi Lushnjës; në rrjetin dhe kuadrin e sektorit të tregëtisë shtetit (ZP, 1949); gjykohet para gjykatës lart (ZP, 1949); personelin e Ministris Ekonomisë (ZP, 1949); problemi i organizatës gruas (ZP, 1949); për mbrojtjen dhe zbatimin e vijës partisë (ZP, 1949); Pamje nga rafineria naftës (ZP, 1956); çdo vit është rritur numuri kuadrove (ZP, 1957); të kooperativës shërbimeve të ndryshme (ZP, 1960); në 3-4 kooperativa të ushës Kavajës (ZP, 1963); nga kolektivi punonjës i Repartit përzier (ZP, 1960). Nga një gjurmim shterues që i kemi bërë rubrikës Teatër për vitin 1960 midis rasteve: Teatri Estradës, Teatri Operas, Teatri kuk-

18) Një kodifikim pak a shumë të plotë të nyjës kemi në Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt), Tiranë, 1967, 64-68.

llave, Ansambli *këngëve dhe Teatri i Estradës, Teatri i Operas, Teatri i kukllave* dhe *Ansambli i këngëve* na del një raport 13:6,7 b) përshtatje e gabuar e nyjës në rasi të ndryshme: Mbi arkivolet të mbuluar me flamure janë vendosur dekoratat e shumta (ZP, 1948); do të vendosen përpara selisë të Komitetit Qendror (ZP, 1948); Punimet e Asamblesë të Kombeve të Bashkuara do të marrin fund (ZP, 1948); të shumicës të të gjithë botës (ZP, 1948); bilanci i punës të Partisë (ZP, 1948); nga ana e organizatës të gruas (ZP, 1949); sidomos fshatarët e periferisë të qytetit (ZP, 1949); për nder të 70 vjetorit të dit-lindjes të Gjeneralizmit Stalin (ZP, 1950); n'emër të gjithë rinisë të Shqipërisë (ZP, 1956); Sot mbushen 50 vjet nga dita e lindjes të Kristaq Antoniut (ZP, 1957); për nderin e madh që i bëhet punës të minorëve në vendin tonë (ZP, 1959); pas përhëndetjes të rastit (ZP, 1960); 18 vjetorit të shpalljes së pavarësisë të Vietnamit (ZP, 1963).

2) Gjithashtu përfundimisht e zgjidhur është edhe përshtatja e drejtë e nyjës së përparme, kur midis emrit ndërhyr një mbiemër, Shmangjet nga norma janë të jashtëzakonshme.

3) Një parregullsi shumë më e madhe haset në përshtatjen e nyjës së përparme, kur midis saj dhe emrit ndërhyr një emër ose një grup fjalësh. Në këto raste sipas normës problemi zgjidhet në këtë mënyrë:

a) nëqoftëse emri që prihet nga nyja është një përcaktues i emrit të parë, nyja përshtatet me këtë të fundit, p.sh. *përfaqësues* të tjerë të artit dhe të kulturës të Kryeqytetit (ZP, 1963); *bukën* e gojës të popullit (ZP, 1942); janë duke u prodhuar nga *punonjësit* e oficinës të kombinatit (ZP, 1963); disa suksese që kanë arritur *punonjësit* e oficinës të kësaj ndërmarrjeje (ZP, 1964);

b) nëqoftëse emri i tretë që prihet nga nyja, është një përcaktues i emrit të dytë, atëherë edhe përshtatja e tij bëhet pikërisht me këtë emër e jo me emrin e parë, p.sh. Sekretari i parë i Komitetit të partisë (ZP, 1959); *punonjësit e repartit të seleksionimit* e rindreqjes (ZP, 1962).

c) nëqoftëse emri i tretë përbën një përcaktues jo të njërit ose tjetrit emër prirës, por të mbarë togfjalëshit (i cili emërton një send të vetëm), atëherë përshtatja bëhet me tërë togfjalëshin e gramatikisht bëhet me emrin e parë të këtij togfjalëshi, p.sh. *partisë së punës të Shqipërisë* (ZP, 1959); *Kolektivi i fabrikës së çimentos të Krujës* (ZP, 1967).

Për të tria rastet ka shmangje të shumta, p.sh. a) pushkatimi me gjakftohtësi prej katili të katër djelmoshave në burgun e Vlorës (ZP, 1942); Në emër të kryesisë të këshillit të Përgjithshëm të invalidëve (ZP, 1948); në sektorin e kufirit *Bilishit* (ZP, 1949); me të gjithë punonjësit e drejtorisë së kryeqytetit (ZP, 1956); për nxjerrjen jashtë ligjës së Partisë komuniste gjermane (ZP, 1956); Delegacioni u prit nga zv. ministri i tregëtisë të Republikës popullore të Shqipërisë (ZP, 1958); pleniumi i shkurtit të Komitetit Qendror të Partisë (ZP, 1960);

b) rifillimi i punës të Komisionit Atomik (ZP, 1948); Komitetit Qendror të Partisë të Punës të Shqipërisë (ZP, 1949); kërkonin dorëheqjen e qeverisë të Ali Aminit (ZP, 1962);

c) Sekretari politik i Komitetit të Partisë së këtij qyteti (ZP, 1942); Organizatat e gruas së rrethit të Tiranës (ZP, 1948); Organizata e gruas së këtij qyteti (ZP, 1949); Vendimi i Komitetit Central të P.P. Shqipërisë (ZP, 1949); Këshilli i Ministrave të Bullgarisë aprovoi planin (ZP, 1949); sekretare e II-të e Komitetit të Partisë së Tiranës (ZP, 1949); në organizatën bazë të partisë së Okshtunit (ZP, 1956); Bashkimi i rinisë së punës së Shqipërisë (ZP, 1956); delegacioni i Partisë së punës së Shqipërisë (ZP,

1957, 1958, 1959, 1960); katër delegate për në konferencën e paqes së rrethit (ZP, 1957); Ministri i punëve të jashtme të Republikës Popullore të Kinës (ZP, 1962); seksioni i bujqësisë të rrethit nuk kishte asnjë evidencë (ZP, 1963) ansambli i këngëve dhe valleve të Republikës Demokratike të Vietnamit (ZP, 1969); organizatës së rinisë së Konispolit (B. 1969).

4) Problemi i nyjës së përparme të disa emrave, ndiemrave të substantivuar e ndonjëherë përmrave femërorë në gjindore-dhanore paraqet më fort lëkundje në periudhën e parë, kurse dalëngadalë ka ardhur duke u njësuar në të mirë të nyjës së përparme së. Në periudhën e parë gjejmë: sigurimi i t'ardhmes s'onë (ZP, 1942); për t'i prerë rrugën kësaj të reje (ZP, 1942); i hedh një sy të kaluarës (ZP, 1948); garancia e jetës së tij, e t'ardhmes së tij (ZP, 1948); kujtimet e hidhura të kësaj të kaluarë (ZP, 1952); Detyrat e partisë realizohen në luftë kundër të vjetrës (ZP, 1952); u çfaqën kundër të drejtës së kombeve për vetvendosje (ZP, 1949); pengojnë hyrjen e të resë (ZP, 1956); ata përhapin idetë armiqësore, sipas të cilave gjoja roli drejtues i partisë pengokërka aktivizimin e masave (ZP, 1956); Si t'ia bëj moj Ollga? — tha ajo të motrës (ZP, 1958).

Një problem tjetër përbën mungesa ose mospërsëritja e nyjës së përparme edhe kur kjo është kuptimisht e domosdoshme, p.sh. përpiquej ta bënte truallin e toskës e__të parëve tanë «plaçkë tregu» (ZP, 1942) — duhej: të të parëve; Në këtë ditë zije të rëndë për ju, thuhet ndër të tjera në telegramin që i dërgon Lidhjes së grave polake, kryesia e BGSH, në ndodhemi me zemër afër jush dhe ju shprehim ngushëllimet më të sinqerta__të gjitha grave të Shqipërisë (ZP, 1956) — duhej: të të gjitha grave të Shqipërisë, sepse telegrami ngushullon gratë polake e jo gratë e Shqipërisë. Sekretin e duarve të shpejta të shoqeve të saj, sidomos __së motrës dhe Vangjes (ZP, 1958) — duhej: të së motrës; për t'iu përgjigjur me vepër të thirrjes së partisë dhe__qeverisë (ZP, 1966) — duhej: thirrjes së partisë dhe të qeverisë, sepse përndryshe lind mundësia për ta interpretuar kështu: për t'i përgjigjur thirrjes së partisë — për t'iu përgjigjur qeverisë. Për këtë na bind fakti që po në atë numër gazete thuhet: të Frymëzuar nga thirrja e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Ministrave — mungesa e nyjës e do të linte mundësi keqinterpretimi sikur Komiteti Qendror është jo vetëm i Partisë por edhe i Këshillit të Ministrave.

Në disa raste, kur para nyjës së përparme bashkërditen dy emra, ose, kur emri pasues është në shumës, edhe nyja e përparme haset në numrin shumës, pra, në vend të mënyrës më të rëndomtë, të përshtatjes me fjalën e fundit, p.sh. tradhëtarët po dridhen përpara drejtësisë dhe hakmarrjes së popullit t'onë (ZP, 1942), hasen: do të thotë të bësh një hap për zhdukjen e injorancës dhe prapambetjes të masave punonjëse (ZP, 1948); shikon luftëtaren e vendosur për mbrojtjen e lirisë e indipendencës të vëndit. (ZP, 1948); shokun Enver Hoxha frymëzonjësën dhe edukonjësën të Partisë dhe të popullit tonë (ZP, 1948); Në vitin 1948, kolkozet dhe sovkozet të zonës së stepave (ZP, 1949); u kanë drejtuar telegrame ngushëllimi Komitetit Qendror... dhe Ambasadës të R.P. të Polonisë (ZP, 1956); janë tani në qëndër të vëmëndjes të organizatave bazë (ZP, 1958); punonjësit e repartit të seleksionimit e rindrejtjes të pjesëve të këmbimit (ZP, 1962); Shirat e shumta, bora dhe akulli të kohëve të fundit në vendin tonë, krijuan pengesa (ZP, 1963) etj.

Një problem më vete përbën përshtatja e nyjeve në rastet kur pas emrit femëror në gjindore-dhanore vjen një emër tjetër femëror i paranyjëzuar ose mbiemër i nyjshëm paravendosur një emri (e vërteta, e drejta, e bija, e mjera nënë etj.). Në publicistikë hasim: filloi vjelja e të lashtave

(ZP, 1957, 1960); fushatën e korrje-shirje-grumbullimit të të lashtave (ZP, 1957); 96 përqind të sasisë së të lashtave (ZP, 1957); plani i korrjes së të lashtave (ZP, 1957), Pra, kur emri femëror i dytë është në numrin shumë, problemi është i zgjidhur përfundimisht në të mirë të së të, dhe nuk mund të ishte ndryshe, prandaj nuk na duket e drejtë zgjidhja e Komisionit të «Rregullave të drejtshkrimit», që pranon si të mundshme edhe *së të dhe të së lashtave*¹⁹.

Për rastet, kur emri i dytë është në njëjës, ka lëkundje. Ne mendojmë, meqë shumësi është zgjidhur në mënyrë të padiskutueshme në të mirë të trajtave *së të*, do të ishte mirë që të përgjithësohej kjo mënyrë edhe në njëjës, pavarësisht nga luhatjet e ndryshme që mund të ndeshen në gjuhën e folur. Edhe në gjuhën e folur ne mendojmë se janë më të rëndomta: i thashë vajzës *së të vogëlës*; luftojnë kundër prapambetjes *së të resë* në fshat etj., se sa rendi i anasjelltë. Edhe Komisioni i Rregullave të drejtshkrimit (po aty), sadoqë nuk është shprehur prerazi në të mirë të njëjës apo tjetrës formë, duke dhënë së pari rendin *së të*, pastaj në kllapa *të së*, mendojmë se ka parapëlqyer pikërisht rendin e parë.

III. Nga fusha e mbiemrave mund të bëhen vërejtje përsa i përket rendit të dy ose më shumë mbiemrave, formës së shumësit dhe fjalëformimit të mbiemrave.

1. Rendi i mbiemrave në shqipe ka një rregullësi të caktuar. Këtu vërehen disa nënndarje a) nëqoftëse kemi të bëjmë vetëm me një pronor dhe një mbiemër (ose dy mbiemra të bashkërenditur) (pavarësisht të njëjshëm apo të panyjshëm), atëherë mbiemri zakonisht vendoset pas pronorit, p.sh. *masave tona punonjëse* (ZP, 1969), *institucionet e tjera qendrore* (ZP, 1969). Ky qëndrim revolucionar dhe kjo gatishmëri luftarake e rinisë sonë janë shprehje e dashurisë së saj të zjarrtë për partinë tonë dhe shokun Enver Hoxha (ZP, 1969). Në publicistikën tonë ashtu si edhe në gjuhën letrare, veçanërisht në periudhën e parë të saj hasim thyerje të shumta të kësaj rregulle, p.sh. Mustafai me disa shokë *të shitur të tjerë* (ZP, 1942); Mirseardhjen ia bëri me gjakun e djemve *më të mirë të tij* (ZP, 1942); ai ka dërguar në front rezervat *e fundit të tija* (ZP, 1942); populli i jonë i hedh një sy. . . luftës *së përgjakëshme dhe të paprerë të tij* (ZP, 1948); të shofij gabimet e *rënda të saja*; miku *m'i dashur dhe m'i math i ynë* (ZP, 1948); nën udhëheqjen e P.P.SH. dhe Sekretarit të Përgjithshëm *të saj* (ZP, 1949, 1950); e vetmja rrugë për përmirësimin e konditave *materiale dhe kulturele të saj* (ZP, 1956). Duhet thënë se mbizotërues është rendi i rregullt që dhamë në fillim.

b) nëqoftëse kemi të bëjmë me dy a më shumë mbiemra të një fare (pra të dy të panyjshëm, prkt. të dy të njëjshëm), rendi i tyre zakonisht është, nga mbiemri që tregon një nocion më të përgjithshëm tek ai që tregon një nocion më të ngushtë (më të veçantë), p.sh. rinisë *femnore popullore shqiptare* (ZP, 1942); ja e vërteta që t'i themi neve popullit *kreshnik shqiptar* (ZP, 1942); Ky është qëllimi i kjartë si kristali i shoqërisë *Anonime bujqësore shqiptare* (ZP, 1942); realizimi i dëshirës *së madhe të përbashkët* (ZP, 1943); udhëheqja *nacionaliste troskiste jugosllave* (ZP, 1949); me këngën *popullore tiranase* (ZP, 1947); priti delegacionin *tregëtar qeveritar kinez* (ZP, 1964); Edhe këtu ka shkelje, p.sh. Qeverisë së Republikës *Algjeriane Demokratike dhe Popullore* (ZP, 1964); u dhanë grushtet dërmuese forcave *fashiste agresive* (ZP, 1956); gjithë popullit *shqip-*

19) Rregullat e drejtshkrimit të shqipes, Tiranë, 1967, 66.

tar heroik (ZP, 1949); Lufta e fundit e tmerrshme na la pa strehë (ZP, 1949).

Por kur njëri mbiemër është një përcaktues më i afërm i mbiemrit tjetër, atëhere zakonisht përcaktuesi është në vend të dytë, pavarësisht nga gjerësia e nocionit që shpreh e bile pavarësisht nëse është i nyjshëm apo i panyjshëm, por, megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që të jetë në vend të parë p.sh. të organizuara... sipas formës *shtypëse më reaksionare dhe më të tmerëshme* (ZP, 1942-; janë shembull i komunistëve *revolucionarë të paepur* (ZP, 1968); duhet të zhvillojmë në një shkallë më të lartë inisiativën *krijuese revolucionare* (ZP, 1968); Brenda në këto skuadra *tipike fashiste* (ZP, 1942) etj

c) Nëqoftëse kemi dy a më shumë mbiemra të përzier (d.m.th. të nyjshëm e të panyjshëm), atëhere rregullisht në fillim vendosen mbiemrat e nyjshëm pastaj të panyjshmit. Kjo rregullë, ashtu si në gjithë gjuhën letrare, me përjashtime të rralla, zbatohet qysh në vitet e para të publicistikës sonë të pasçlirimit, p.sh. Rroftë Shqipëria e lirë e pandashme *independentë e demokratike* (ZP, 1942); Këshilli i *përkohshëm Nacional-Çlirimtar* (ZP, 1942); me shpirtin e tij të artë e të brujtun me idealin *më të lartër njerëzor* (ZP, 1942); sulmi *më i madh sovjetik* bëhet (ZP, 1942); në kampin e fuqishëm demokratik e anti-imperialist (ZP, 1949); nxori nevojën e një pune *më të madhe politike* (ZP, 1949); formimi i klasës *së re puntores* (ZP, 1956); maqina *të reja automatike elektronike poloneze* (ZP, 1956); do të zgjedhin Komitetin e ri *Qendror* (ZP, 1948), kanë një shembull të *shkëlqyer pozitiv marksist-leninist revolucionar* (ZP, 1968).

Arësyeja për të cilën shkelet ky rend është se në disa raste emri me mbiemrin e panyjshëm karakterizues mendohet, dhe shpesh janë me të vërtetë, si një togfjalësh i qëndrueshëm i pandashëm, e atëhere mbiemri i nyjshëm nuk vendoset midis tyre, por shtohet pas mbiemrit të panyjshëm, p.sh. nuk është në gjendje për një *luftë frontale të gjerë* (ZP, 1942); patriotët shqiptarë me *tendenca politike të ndryshme* (ZP, 1942); do të zgjedhë *Komitetin Central të ri* (ZP, 1948, 1949). Kjo është historia e *partisë Komuniste më të re* në Evropë (ZP, 1948); në lidhje me *gjendjen politike të jashtme* (ZP, 1949); Bazat ideologjike të *partisë punëtore poloneze të bashkuar* (ZP, 1949); sivjet ka një *mekanikë bujqësore më të madhe* se çdo herë tjetër (ZP, 1963) etj. Siç del edhe nga shembujt e mësipërm, ky rend në disa raste është krejt i përligjur, kur mbiemri i dytë përbën një përcaktues të mbiemrit prirës, ose kur lidhja e emrit me mbiemrin pasues është shumë e ngushtë, por zakonisht mendojmë se, meqë prirje e përgjithshme është ajo që përmendëm në krye të pikës c, është më e drejtë që në përgjithësi të ruhet rendi *mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm*. Edhe kur kemi të bëjmë me togfjalësha të qëndrueshëm, elementi i dytë i të cilëve është një mbiemër i panyjshëm, mbiemri përcaktues zakonisht futet midis, p.sh. Kina e *madhe* popullore; *Revolucioni i madh Socialist i Tetorit* etj.

ç) Rendi i mbiemrave nuk është gjithmonë i qëndrueshëm edhe kur një emër i përcaktuar nga një mbiemër përcaktohet më tej edhe nga një emër në rrjedhore (ndonjëherë edhe gjindore). Megjithëse në këto raste mbizotëron rendi *emër + mbiemër + emër në rrjedhore*, propëseprapë, jo rrallë haset edhe rendi i kundërt, çka, sipas mendimit tonë, flet për prirjen që kanë këta togfjalësha për t'u bërë togfjalësha të qëndrueshëm jo vetëm leksikalisht, por për t'u trajtuar edhe gramatikisht si të ishin një fjalë e vetme. Megjithatë kjo prirje ende nuk është kthyer në një fakt të përgjithësuar gjuhësor. Kështu, ndërsa nga njëra anë gjejmë: një *çantë*

shpine angleze (ZP, 1949); vënien në shfrytëzim të një numuri *automjeteve të transportit të shkatërruara* (ZP, 1949); të të gjithë *partizanëve të paqës brazilianë* (ZP, 1952); në shumë ndërmarrje vazhdon të ketë akoma *humbje kohe të pajustificuara* (ZP, 1956), *modele këpucësh të shumta* (ZP, 1956); operoi të sëmurin për një *defekt zemre të lindur* (ZP, 1959); ajo ka një *volum pune më të madh* se çdo vit tjetër (ZP, 1963); me duhan janë mbjellë *sipërfaqe toke më të mëdha* nga plani (ZP, 1965); zëvendësuan *gazetat e murit burokratike të mëparëshme* (ZP, 1967) etj. nga ana tjetër, hasim më rëndom: duhet t'i shirohen një regjimi *të fortë* pune dhe studimi (ZP, 1956); duhet të krijojë kondita *më të mira* pune (ZP, 1956); duhet ta vëmë komitetin e ri të partisë në pozita *më të shëndosha* drejtimi (ZP, 1956); modele *të reja këpucësh* (ZP, 1956); ky është një sektor *i ri* pune (ZP, 1956); detyron ata vetëm për punë *të rënda* krahu (ZP, 1959); një volum *i mirë* pune (ZP, 1960).

Ne mendojmë se do të ishte mirë të ruhej kjo karakteristikë dalluese e shqipes që edhe midis togfjalëshave të qëndrueshëm lejon të hyjë mbiemri karakterizues i gjymtyrës së parë të togfjalëshit dhe që kjo veçori të ruhej në të dyja rastet, si atëhere kur togu përbëhet prej një emri dhe një mbiemri, edhe kur përbëhet nga një emër çfarëdo dhe një emër në rrjedhore (prkt. gjindore). Kjo ndihmon njëherazi edhe për një kuptim shumë më të qartë.

2. Përsa i përket shumësit të mbiemrave të prejardhur për konversion nga emrat përgjegjës: *agjent, sportist, fiskulturist, komunist* etj. vlen po ajo vërejtje që bëmë për emrat përkatës.

Edhe për mbiemrat që mbarojnë me *-i* të theksuar vlen po ajo vërejtje që përmendëm për emrat e këtij tipi, ata po grumbullohen në një grup të vetëm duke e formuar shumësin me *-nj* (këtu edhe ata që dalin në *-a* të theksuar: *budalla, maskara* etj. dhe *i madh*).

3. Nga fusha e fjalëformimit të mbiemrave interes më të madh paraqet formimi i mbiemrave me anë të prapashtesave dhe midis këtyre të fundit më me rëndësi janë prapashtesat *-(ë)s* dhe *-shëm*.

3. 1. Prapashtesa *-(ë)s* haset tek mbiemrat e formuar për konversion nga emrat përgjegjës, ose edhe drejtpërsëdrejti për analogji me këta të fundit. Prandaj edhe për këta mbiemra vlen po ajo vërejtje që bëmë për emrat në *-(ë)s*.

3. 2. Prapashtesa *-shëm* është ndoshta prapashtesa më prodhuese në fjalëformimin e mbiemrave të shqipes. Me anë të kësaj prapashtese (veç mbiemrave parashitesorë të tipit *i përbotshëm*) formohen mbiemra prej pjesoreve, prej emrave dhe prej ndajfoljeve. Për mbiemrat prejpjesorë në periudhën e parë të publicistikës sonë të sotme, ashtu si në mbarë gjuhën letrare në variantin e saj jugor, mbizotërojnë mbiemrat pa prapashtesë të tipit: *zjarrin e pashuar* dhe etjen e *pashteruar* (ZP, 1942) dhe mbiemrat e formuar nga pjesorja e dialektit jugor me anë të prapashtesës *-shëm* të tipit: *E natyrëshme...* dhe fare *e kuptuarshme* për ne (ZP, 1942); një paqe të *qëndruarshme* (ZP, 1948); me gëzim të *papërshkruarshëm* (ZP, 1950); përpjekjet e *vazhduarshme* (ZP, 1950); në mënyrë të *padiskutuarshme* (ZP, 1952); Këto të dy tipe mbizotërojnë në krahë me mbiemrat e formuar nga pjesorja e dialektit verior me anë të prapashtesës *-shëm* (p.sh. u shkrojt një nga faqet më të *shkëlqyeshme* (ZP, 1942); *humbjet* e tij janë të *pazëvendësueshme* (ZP, 1942). Edhe kjo gjendje përsa i përket temës prodhuese prej nga formohen mbiemrat me *-shëm*, nuk vazhdoi më gjatë se deri nga fundi i vitit 1952. Që nga ajo

Fallefor
mb

kohë e deri në ditët e sotme kjo gjendje ndryshoi në mënyrë të patundshme në të mirë të tipit: *i vazhdueshëm*.

Është me interes të shënojmë se edhe në publicistikë del, sadoqë në mënyrë shumë sporadike, një çfaqje e tretë, që ishte më afër shqiptimit më të përgjithësuar në gegërishten: eksperiencës së *çmuëshme* (ZP, 1948); *i pamjaftuëshëm*. Kjo trajtë është përdorur edhe para çlirimit dhe i përgjigjet më drejtë shqiptimit të sotëm mbarëshqiptar të mbiemrave të tipit: *i qendrueshëm*, ku togu *-ue* shqiptohet vetëm *-u*. Këtë e hasim edhe për mbiemrat në *-s*: *vdekjepruëse* (ZP, 1948, 1952). Por në goftë se ti pet i *qëndruarshëm* dhe i *qëndruëshëm* nuk i qëndruan provës së kohës, mbiemrat prejpjesorë pa prapashtesa që bartin dy kuptime: 1) atë prejjesor të mirëfilltë dhe 2) atë që zakonisht shprehet nga mbiemrat me *-shëm*, megjithëse dalëngadalë po zëvendësohen prej këtyre të fundit, prapëseprapë paraqesin një qëndrueshmëri relativisht të madhe. Kështu gjatë gjithë publicistikës sonë të sotme hasen në një masë relativisht ende të gjerë mbiemrat prejpjesorë të tipit: Partija e jonë... po vjen në Kongresin e saj të parë si luftëtare e *pamposhtur* (ZP, 1948); besnikërinë e *patundur* të partisë dhe të popullit tonë punonjës (ZP, 1948); qendron si një shkëmb *i pathyer* (ZP, 1948); E lavdishme është e kaluara e «Zërit të popullit»; ajo është e *parandë* nga historia e Partisë sonë (ZP, 1948); sukseset e *shkëlqyera* (ZP, 1949); duhen plotësuar me një studim të *vazhduar* (ZP, 1949); të thyejnë vullnetin e *pamposhtur* të popullit (ZP, 1949); Populli ish *i pamposhtur*, populli do të dilte fitimtar (ZP, 1949); udhëheqësi *i shquar* (ZP, 1952); puna e *palodhur* (ZP, 1950); të gjitha këto kanë bërë të mundur që të shtohet prodhimi (ZP, 1956); për të mënjeluar... humbjet e *pajustificuara* (ZP, 1956); të gjesht njeri pa punë është e *palundur* (ZP, 1956); besimi ynë për ta është *i patundur* (ZP, 1957); ky takim i përzemërt do të jetë *i paharruar* (ZP, 1957); ky kontinent i madh dhe *i pamatur* (ZP, 1958); gëzimi që *i papërshekruar* (ZP, 1958); 10 Korriku — ditë e *paharruar* (ZP, 1966); për të marshuar kurdoherë në vijën e parë të frontit të luftëtarëve të *pamposhtur* të çështjes së socializmit (ZP, 1967) etj. etj.

Ka shumë mbiemra prejpjesorë, të cilët janë ngulitur si të tillë dhe shpeshherë duket sikur është e pamundshme të zëvendësohen me përgjegjësit e tyre me *-shëm* (kh. *i dalluar*, *i shquar*, *i shkëlqyer*, *i padrembur* etj.), por për hir të një diferencimi më të qartë kuptimor, për të mos lejuar dykuptimshmëri dhe keqinterpretim, do të ishte mirë që rruga që kanë marrë mbiemrat prejpjesorë pa prapashtesa në përgjithësi drejt zëvendësimit të tyre nga mbiemrat me *-shëm*, të shpejtohej akoma më tepër.

Megjithëse pjesorja e foljes *marr* bën *marrë*, për arsye semantike mbiemrin prejpjesorë e hasim pothuajse vetëm *i marrur* (zotimet e *marrura*, masave të *marrura*, funksionet e *marrura* etj.)

Është me interes të shënojmë se në publicistikën e sotme haset një paralelizëm midis mbiemrave me kuptim përkatësor dhe emrave në rrasë të zhdrejta, kështu në të njëjtin artikull për të shprehur përkatësinë gjejmë një herë mbiemër e një herë emër, p.sh. Klubi i puntorëve *hekurudhorë* (ZP, 1949); Puntorët e *hekurudhave* (po aty); Qeverisë *franceze* (ZP, 1949); qeveritarët e *Francës* (po aty); para organeve të *shtetit* (ZP, 1949); organet shtetërore (po aty); Këshillit qendror të *Sindikatave* (ZP, 1949); këshilli *sindikal* (po aty); Këshillit *ministror* (ZP, 1949); Këshillit të *Ministrave* (po aty); në Kampin e *demokracisë* (ZP, 1949); *Kampi Demokratik* (po aty); R.P. të *Rumanisë* (ZP, 1956); R.P. *rumune* (po

aty); industrisë *vajgurore* (ZP, 1956); industrisë së *vajgurit* (po aty); Çështjet e ndërtimit *kooperativist* (ZP, 1956); çështjet e ndërtimit të *kooperativave* (po aty); mbjelljet *pranverore* (ZP, 1957); mbjelljet e *pranverës* (po aty); mbjellja e misrit në *hamullore* (ZP, 1958); misrit *hamullor* (po aty); planin *9-mujor* (ZP, 1958); planin e *9-muajve* (po aty) etj.

Për strukturën fjalëformuese të mbiemrave të formuar me parashtesa dhe mbiemrat kompozita vlen e njëjta vërejtje që bëme për emrat e formuar në këtë mënyrë.

Nga numërorët meriton të vihet në dukje se ish-emrat *milion*, *miliard* janë shndërruar plotësisht në pjesë përbërëse të numërorëve përkatës, pra nuk duhen trajtuar më si emra. Për këtë dëshmon, ndër të tjera, fakti që ata në bashkëvajtje me çdo numëror tjetër dalin të pandryshueshëm — nuk ndryshojnë as në rasë as në numër, ashtu si edhe çdo numëror tjetër: *dhjetë*, *qind*, *mijë* etj., p.sh. prej *6 miliard* dollarrësh (ZP, 1950); *11,5 milion* (ZP, 1956); mbi *5 milion* lekë të ardhura (ZP, 1957); *150 milion* lekë (ZP, 1959); *10 milion* lekë (ZP, 1960); *dy milion* puntorëve metalurgë (ZP, 1963); *97,7 miliard* franga (ZP, 1964); tri ose katër *miliard* dollarë (ZP, 1965) etj. Këta marrin shumës si gjithë numërorët e tjerë, kur tregojnë një sasi të madhe sendesh, por të papërcaktuar me saktësi, p.sh. *miliona* nënave në botë (ZP, 1950); disa *miliona* lekësh (ZP, 1956); me *miliona* njerëz (ZP, 1963) etj. (kh. midis *qindra* të rijsh (ZP, 1967); *dhjetra* puntorë të dalluar (ZP, 1966); *qindra* e *mijra* njerëz (ZP, 1966).

Gjinia femërore e numërorit tre (forma *tri*), paraqitet mjaft e lëkundshme në të mirë të mashkullores *tre*, p.sh. Dhe këto *tre* skuadra kanë hyrë në veprim (ZP, 1942); u ka vënë zjarrin *tre* shtëpive (ZP, 1943); *tre* ditë rrjesht (ZP, 1949); një automatik me *tre* karikatore (ZP, 1949); u qëndroi për *tre* orë sulmeve (ZP, 1949); pushuan padrejtësisht nga puna *tre* edukatore (ZP, 1956); në më pak se *tre* ditë (ZP, 1962), *tre* shkolla të reja (ZR, 1967); *tre* gratë (P, 1967) etj. Ndërkaq tek emrat që në shumës ndërrojnë gjini, haset më rëndom trajta femërore *tri*, p.sh. në *tri* turne (ZP, 1956); të *tri* grupet (ZP, 1956); *tri* xhepe (ZP, 1957); *tri* ekiye (ZP, 1957); *tri* prodhime (ZP, 1958); *tri* mjete (ZP, 1960) etj. Mendojmë se është më e këshillueshme që ky tipar dallues i shqipes të ruhet, pra të dallohet forma e gjinisë femërore nga forma e gjinisë mashkullore.

IV. Edhe për përemrat në përgjithësi nuk ka probleme teorike të pazgjidhura për normën gjuhësore, por në zbatimin praktik ka një numër çështjesh që paraqesin interes për kristalizimin e kësaj norme.

1. Nga fusha e përemrave vetorë është për t'u përmendur luhatja mjaft e madhe që vihet re tek përemri i vetës së parë dhe të dytë shumë për rasën emërore, në vend të ne, ju hasen shumë shpesh *neve*, *juve*, p.sh. ja e vërteta që t'i themi *neve* popullit (ZP, 1942); *neve* pamë atje (ZP, 1950); *neve* menduam (ZP, 1950, 1966); kur keni qenë *juve* (ZP, 1956); Prandaj *juve* me pendën tuaj... po i damkosni (ZR, 1967); Pra *juve* Trombos, merrni ushtrinë tuaj (ZR, 1967); Por edhe *neve* nuk do të mbetemi pas (ZR, 1967); *neve* nuk jemi thelluar (P, 1967); për masat që keni marrë *juve* vetë (P, 1967). Përhapja e këtyre formave dialektore në gjuhën letrare nuk duhet lejuar.

2. Parregullsitë më të mëdha në fushën e përemrave vërehen në përdorimin e trajtave të shkurtëra të përemrave dhe tek pronorët.

2. 1. Në përdorimin e trajtave të shkurtëra të përemrave vetorë vërehet një numër relativisht i madh shmangjesh, ndër të cilat vendin e parë

e zë ngatërimi i vetes së tretë shumë me vetën e tretë njëjës në rasën dhanore. Në të gjitha organet e shtypit tonë, ashtu si edhe në gjuhën e folur dhe në gjuhën e letërsisë artistike, haset një numër i madh rastesh të një ngatërimi të tillë, ku njëjisi përdoret në vend të shumës dhe ky ngatërim vazhdon të jetë mjaft i rëndomtë edhe sot e gjithë ditën, p.sh. në Brindizi turmat e popullit që i çuan grushtin kërcënues katilave me këmishë të zezë, u qëlluan (ZP, 1942); populli i jonë i hedh një sy vjetëve të luftës (ZP, 1948); foli... për luftën që i duhet bërë çfaqjeve të ndryshme burokratizmit (ZP, 1949); do t'i japë energji shumë qyteteve (ZP, 1952); Kështu i përgjigjemi detyrave që na shtron partia (ZP, 1956); kjo vizitë... i dhe mundësi kryetarëve (ZP, 1959); Qeverija kineze i bën thirrje të dy kryetarëve (ZP, 1963); dëborë e parë... i dha një pamje të bukur dhe poetike rrugëve shesheve dhe kodrave (ZP, 1967); Përsa i përket vetë autoriteteve (ZP, 1967); A është e mjaftë ndihma që ne do t'i japim shokëve tanë të malësisë (ZP, 1968); të punojnë pa u lodhur për t'i ardhur në ndihmë kooperativistëve (B. 1968); ne jemi të detyruar t'i përgjigjemi blerësve (P, 1967); ata i drejtohen si me të qarë komandantëve (ZR, 1967) i ngjiten maleve (ZR, 1967); përsa i përket t'ardhurave (D. 1967); ai vetëm sa i afrohet këtyre sukseseve kryesore (D, 1967) etj; Ka shumë gjasë që kjo shtrirje analogjike të vijë nën ndikimin e emrit në kallëzore që ndodhet shumë shpesh më afër trajtës së shkurtër, dhe, ndoshta, folësi në mënyrë të pavetëdijshme, në vend që të bëjë përshtatjen e përligjshme me emrin shumë në dhanore, e bën gabimisht me emrin tjetër në kallëzore.

Pavarësisht nga shtrirja relativisht e gjerë, kjo trajtë duhet mënjanuar, sepse, përderisa është përsëritje e emrit në dhanore, detyrimisht duhet të përshtatet me këtë emër në rasë e numër.

Një shfaqje tjetër e gabuar është përdorimi i trajtave përemërore *iu(ju)* për veten e tretë shumë -u, p.sh. i qindrave fshatarëve myzeqarë që me vitre po ju kullon gjaku (ZP, 1942); për detyrat që ju dualën këshillave mbas çlirimit (ZP, 1943); përgjegjësisë që ju binte Komiteteve Ekzekutive (ZP, 1949); përfundimet e planit Marshall nuk iu përgjigjen shpresave (ZP, 1949); ndërsa tani ne do t'iu mësojmë (prindëve — A. Dh.) edhe fjalët aksion, tokmak... (ZP, 1967); Atyre iu përket e ardhmja (ZP, 1967); Punëtoret e përparuara iu erdhën në ndihmë atyre të prapambeturave (P, 1967); Duke ju vënë lehtë këtyre ose atyre fjalëve (D, 1967) etj. Këtu nuk duhet ngatërruar midis tyre rastet kur u është pjesë e foljes në diatezën pësore, p.sh. Pionierëve të kryeqytetit iu shpërndanë 10.000 pako (ZP, 1948); Në fund aktorëve për çfaqjen me sukses të kësaj drame iu dhanë lule (ZP, 1967).

Një shmangje e ngjashme me dy të parat, e cila haset në mjaft organe të publicistikës dhe që duhet mënjanuar, është edhe përdorimi i trajtave *ia (ja)* për *ua*, p.sh. mbasi *ja* vuri hallkën në hundë këlyshve të tij (ZP, 1942); gjermanët kërkojnë... *Fia* hedhin fajin rumunëve (ZP, 1942); ay u këshillua që ato fjalë t'ia thotë edhe italianëve të tjerë (ZP, 1943); Kongresi i parë i kooperativave, antarëve të kësaj kooperative *ia* shtoi akoma më tepër emulacionin (ZP, 1949); të cilin qarqet reaksionare të vendit kërkojnë t'ja furnizojnë imperialistëve amerikanë si mish për top (ZP, 1952); imperialistët nuk mundën t'ia arrijnë qëllimeve (ZP, 1948); Kyri *ia* kushtoi jetën e tij dy çështjeve të pandara nga njëra tjetra (ZP, 1958). Duke ja dhënë votat kandidatëve të frontit (P, 1967); Pati dhe nga ata që u munduan t'ia hedhin fajin *materialeve* (P, 1967); t'ia rrëmbejnë krenarinë maleve tona (D, 1967) etj.

Në vend të trajtave *ua* përdoret rrallëherë gabimisht edhe *ju*, p.sh. Këto fjalë *ju* a drejtojmë atyre që ndjekin akoma rrugën e gabuar (ZP, 1942); mos gëlbrimin *ju* a hoqi krejt, sopata (D, 1967); Ndonjëherë bile ka njerëz që *ju* ushqejnë iluzionet (ZP, 1967) etj. Sa për formën tjetër *jau*, në vend të *ua*, këtë në gjithë materialin e shqyrtuar e kemi hasur vetëm tri herë dhe këto gjatë vitit 1942, p.sh. vanë... *t'ja* u rrëmbenin tokat; Hanxhiu që u tha mjaft *jau* ka prishë gjumin; *jau* ndau të gjithë baretin fshatarëve. Duke u nisur nga fakti që kjo është një shfaqje dialektore dhe e papërhapur, e kemi përmendur edhe gjetkë²⁰ se hartuesit e Rregullave të drejtshkrimit të shqipes nuk duhet ta kishin pranuar këtë trajtë krahas trajtës *ua*²¹.

Kur trajta e shkurtër përemërore përsërit dy emra të bashkërenditur në të njëjtin numër, ekziston liri përshtatjeje, mund të vendoset në njëjës ose në shumës, por më e rëndomtë është mundësia e parë, p.sh. dhe populli i jonë e shprehu haptazi... dashurinë dhe besnikërinë e tij (ZP, 1948); *i* drejtoi nga një telegram përshëndetjeje K.Q. të P.P.Sh. dhe K.Q. të B.P.Sh. (P. 1967); një vëmendje të veçantë *i* kushtuan tregëtimit të mallrave të konsumit të gjerë dhe plotësimit të kërkesave të reja (B, 1968); *t'ia* nënshtroin çdo çfaqje të huaj kritikës e autokritikës (P, 1967); por: Ajo nuk e pengoi as Xhonsinin dhe as Kosiginin që të hynin në shkëmbim mendimesh të gjata dhe të sinqerta në Glasboro (B, 1967); Popullsia e fisit Naga në Indi vazhdon *t'u* japë grushte të rënda ushtrisë dhe policisë reaksionare të qeverisë së Kongresit (B, 1967). Përshtatja është e lirë edhe kur ndonjëri nga emrat pasues është në shumës; kjo mund të bëhet me emrin më të afërt, në njëjës, ose me tërë emrat pasues, dmth të vendoset në shumës, p.sh. nga rreziku që *i* kërcënohej lirisë, indipendencës dhe gjithë fitoreve *t'ona* (ZP, 1948); Puna.. nuk *i* përgjigjet vrullit, entuziazmit dhe kërkesave të masave (ZP, 1956); *i* përshtatet klimës dhe kushteve të tokës (ZP, 1957); përsa *i* përket Ministrisë së tregëtisë dhe ndërmarrjeve të tjera (ZP, 1958); Ajo e para *i* shpalli luftë konservatorizmit dhe zakoneve prapanike (ZR, 1967); ashtu si malet tona *u* përshtaten tokës dhe konditave (ZP, 1948) etj.

Rrallë haset edhe përdorimi i gabuar i trajtës së shkurtër përemërore u për *ju* (= juve *ju*), p.sh. Në emër të kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Invalidëve të L.N.Çl. u sjell përshëndetjet revolucionare të të gjithë invalidëve (ZP, 1948); — «O Be-xhet!» ... — Ehe-he!... *u* kanë ardhë shokët nga Shkodra, more! (P. 1967); Juve *u* takon të udhëtoni me tren. Pranë *ju* kalon një njeri që *u* drejtohet: «Ju lutemi biletat» (P, 1967); A mund *t'u* siguroj se unë tani menjëherë u bëra afetare (P, 1967); me punën dhe përpjekjet tona do *t'u* tregojmë *ju* shokë dhe gjithë popullit tonë se jemi me të vërtetë revolucionarë (P, 1967); Desha *t'u* marr në telefon me radhë (D, 1967) etj.

2.2. Në fushën e përemrave pronorë ka gjithashtu shmangje shumë të mëdha, por sidomos në vitet e para të publicistikës sonë pas çlirimit, kur, siç është theksuar qysh në fillim, mungonte një kodifikim i normave gjuhësore në përgjithësi. Megjithëse edhe këtu norma e përbashkët letrare ka ardhur dalëngadalë duke u kristalizuar, prapëseprapë, edhe sot e gjithë ditën hasen ende mjaft shmangje.

20) «Rregullat e drejtshkrimit» një hap i mëtejshëm në njësimin e shqipes letrare, «Stud. fil». 3/1968, 210.

21) Shih: Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt), Tiranë, 1967, 33.

Më e rregullt në këtë drejtim paraqitet veta e parë pronori njëjës e gjinisë mashkullore dhe femërore. Një shmangje jo fort e rrallë vërehet në gjindore-dhanoren e gjinisë femërore të numrit njëjës. ku në vend të *sime* përdoret *time*, p.sh. vajzës *time* (ZR, 1967); historinë e ish nxanës *time* (ZR, 1967); kanë kaluar 64 vjet të jetës *time* (ZR, 1967) etj. Kjo shmangje lidhet, ashtu si edhe tek *nyja* e përparme e gjinisë femërore, me shtrirjen e *nyjes të* në dëm të *nyjës së*.

Shumë e larmishme, veçanërisht në periudhën e parë, paraqitet veta e parë pronari shumë për të dy gjinitë, pavarësisht nga numri i pronës. Këtu në vend të trajtave që sot janë normë: *ynë, jonë, tanë, tona* hasim: a) nga vullneti *i ynë* (ZP, 1942, 1948, 1949, 1950, 1956, 1958, 1966); Populli *i jonë* është plaçkitur deri në kockë (ZP, 1942, 1948, 1949, 1952); oficerat *t'onë* (ZP, 1942, 1943, 1948, 1952, 1956, 1958, P, 1967); ju jeni armiq të *jonë* (ZP, 1942); Populli *t'onë* thotë (ZP, 1942, 1949); vendi *jonë* (ZP, 1949, 1957, 1958); as hosteni nuk ish *i yni* (ZP, 1949); kapitali ish *i joni* (ZP, 1949, ZR, 1967); nga lufta e *jonë* (ZP, 1942; 1943, 1948, 1949, 1957, 1958, 1960); në rrotat e lëvizjes *t'onë* nacional-çlirimtare (ZP, 1942, 1948, 1949, 1960); do të na gjejë me një Shqipëri që të jetë e *jona* (ZP, 1942); Partija *t'onë* është ndërtuar në bazë të parimeve marksiste-leniniste (ZP, 1948, 1949); ne po e çojmë përpara kryerjen e detyrës *jonë* (ZR, 1967; B, 1967; P, 1967) etj. Është për t'u përmendur se trajtat sot të rregullta, me ndonjë përjashtim të rrallë, i hasim së pari nga viti 1948 e këtej dhe deri në vitet '50 nuk janë ende mbizotëruese. Për ditët e sotme gjendja po përmirësohet vazhdimisht — trajtat normë sa vjen e më tepër po nguliten në mbarë publicistikën tonë por, siç tregohet edhe nga shembujt e mësipërm, shmangje ka edhe në kohët më të fundit. Veçanërisht mjaft e rëndomtë në të gjitha organet e shtypit tonë është shmangje që haset për gjindore-dhanoren e gjinisë femërore njëjës: *tonë* në vend të *sonë*. Për vetën e dytë numri i përgjithshëm i formave që hasen është më i vogël. Në fillim ndahen disa shfaqje dialektore, të cilat nuk përsëriten më as në numrat e parë të organeve tona të shtypit të pasçlirimit. (kh. trajtat e dialektit verior që hasen gjatë 1942-1943: jetat e *juaja*; armatat e *jueja*; tradhëtit e *juaja*; të jetës *s'ande*; lirinë e *juaj* (ZP, 1942); trutë e *juaja* (ZP, 1943). Trajta e *jote* ka marrë një përhapje më të gjerë dhe ndeshet deridiku shpesh dhe në ditët e sotme, p.sh. e ardhmia është e *juaja* (ZP, 1949); E gjithë Shqipëria është e *jotja* (ZP, 1960); Mirëdita u bë e *jotja* (ZP, 1969).

- Përsa i përket përshtatjes në gjini për vetën III shumë të gjinisë femërore, këtu, megjithë këshillimet e gramatikave të ndryshme,²² edhe në publicistikë mbizotëron trajta pa mbaresën *-a*. Për hir të njësimi të trajtave, meqë veta I dhe II i dallojnë qartë midis tyre trajtat e të dyja gjinive (kh. djali *im* / vajza *ime*; djali *ynë* / vajza *jonë*; djali *yt* / vajza *jote*; djemtë e *mi* / vajzat e *mia*; djemtë *tanë* / vajzat *tona* — por: djali *juaj* / vajza *juaj*) dhe meqë ky dallim edhe për vetën III haset jo aq rrallë si në letërsinë artistike ashtu edhe në publicistikë (kh. rrezet e *tia* (ZR, 1967); traditat e *tija* (P, 1967); poezitë e *saja* (P, 1967); nëpër vjershat e *tija* (ZR, 1967); pyetjeve të *saja* (ZR, 1967) etj), do të ishte mirë të shtrihet përdorimi i mbaresës *-a* edhe për këtë vetë, por realiteti gjuhësor e

22) Shih: O. Myderrizi, *Gramatika e Re e Shqipes*, Tiranë, 1944. 87; K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, 98; P. Elezi — L. Dodbiba, *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1960, 193; Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, dispensë, II, Tiranë, 1961, 131.

ka bërë të tepërt — në mbarë shqipen letrare bashkëkohore është përgjithësuar si mbizotëruese trajta pa mbaresë. Për më tepër, kohët e fundit në dëm të të dy trajtave po shtrihet, sidomos në publicistikë, sa vete e më shumë pronori *vet* (*e*)*vet* (vullnetin *e vet*; nga gjiri *i vet*; për punët *e veta*; kontributin *e vet*; disa pjesë të *vetat*; nën këmbët *e veta* etj.).

Pas një shqyrtimi të tillë të sistemit nominal arrijmë në këto përfundime të përgjithshme: Publicistika e vjetëve të pasçlirimit dhe veçanërisht sistemi nominal në këtë publicistikë dëshmon më së miri për bashkëveprimin, ndër-dialektor që ka ndodhur e po ndodh gjatë kristalizimit të gjuhës sonë të përbashkët letrare kombëtare. Ky bashkëveprim dëshmohet si në leksikon e këtij sistemi ashtu edhe në fjalëformimin dhe formëndryshimin e tij. Në periudhën e parë pas çlirimit sistemi nominal në publicistikën tonë, ashtu si në mbarë gjuhën letrare, paraqitet jo vetëm i larmishëm, — me luhatje e dublete të shumta si në fjalëformim ashtu edhe në formëndryshim, pra, pa norma të përbashkëta, — por njëkohësisht edhe më i ngushtë. Ai jo vetëm në bazën e tij, por edhe në tërësi ishte shumë i ngjashëm me atë të variantit jugor. Dalëngadalë kjo gjendje ndryshoi. E në këtë njësim e kristalizim të gjuhës letrare, krahas lëvritimit të përgjithshëm të gjuhës dhe veprave të tjera gjuhësore, një meritë e padiskutueshme u bie në mënyrë të veçantë rregullave të drejtshkrimit të botuara herëpashere, por sidomos dy botimeve të fundit. Si përfundim sot nuk kemi një përzjerje mekanike të elementëve të dialektit verior, të cilët nuk janë të paktë, me ata të variantit jugor, por një ndërthurje organike midis tyre. Në sistemin nominal të publicistikës sonë në përgjithësi, ashtu si në gjithë shqipen letrare, janë kristaluar norma të përbashkëta gjuhësore. Megjithatë ka një numër jo aq të vogël normash variante, pra, raste ku edhe njëra edhe tjetra formë, pavarësisht nga shtrirja e saj, është e pranueshme. Në përjasje me sistemin nominal të letërsisë artistike, sistemi nominal i publicistikës paraqitet vende-vende pak më i ndryshëm, p.sh. përsa i përket shumësit të emrave të gjinisë mashkullore me mbaresën *-a*, formimit të emrave të vepruesit, prk. mbi-emrave, nga temat foljore në *-o* me anë të prapashtesës *-(ë)s*, numrit më të vogël të shmangjeve etj.²³ Megjithatë edhe sistemi nominal i publicistikës sonë njih një numër relativisht të madh shmangjesh nga format normë. Këto shmangje e kanë burimin ose në ndikimin e gjuhës së folur mbi shkruarit e artikujve të ndryshëm, ose në ndikimin e dialekteve e nëndialekteve, të cilave u përkasin këta. Prandaj detyra më e rëndësishme e gjithë njerëzve tanë që shkruajnë në organet e ndryshme të shtypit, është, në radhë të parë, pikërisht mënjanimi i këtyre shmangjeve.

23) Kh. për të gjitha këto të dhënat e punimit të pranishëm me ato të punimit të M. Çelikut, *Çështje të normës morfologjike në letërsinë artistike pas çlirimit*. «Stud. Fil.» 3/1969.

R é s u m é

OBSERVATIONS SUR LA STABILISATION DE LA NORME LINGUISTIQUE DANS LA PUBLICISTIQUE D'APRES LA LIBERATION

Dans l'article l'auteur fait une première tentative pour un examen historique et linguistique de la langue de la publicistique albanaise après la libération du pays. Il s'agit de la phase la plus importante et définitive pour la stabilisation de la norme commune littéraire sur échelle nationale. L'auteur commence ses observations depuis le premier numéro du «Zëri i Popullit», l'organe du parti qui commença sa parution dans la clandestinité en août 1942. Dans l'article on fait observer que la situation de la langue littéraire albanaise à la veille de la libération du pays, et par conséquent aussi celle du «Zëri i Popullit», dans sa première phase, était non unifiée. L'auteur examine la stabilisation ou la tendance à une norme commune linguistique seulement dans le système nominal.

Le matériel linguistique du «Zëri i Popullit» est rapproché souvent à celui des autres organes: «Zëri i Rinisë», «Bashkimi», «Puna», «Sporti popullor» et «Drita», paraissant après la libération du pays.

Pour ce qui est du nom + substantif l'auteur fait relever une assez grande variété de formes pour plusieurs de ses catégories. Dans l'article est traité le problème de changement de genre au pluriel chez plusieurs noms, celui de la formation du pluriel, de la formation de quelques cas et de la définition des noms. Constatant que chez les noms du genre masculin, qui au pluriel prennent -e et -ra, tant dans la langue écrite que dans celle parlée, a été généralisé le changement de genre au pluriel, l'auteur aboutit à la conclusion que, indépendamment de la conservation réitérée du genre masculin dans ces noms, est juste la recommandation des règles de l'Orthographe albanaise (1956 et 1967) que tous ces noms prennent au pluriel un déterminatif de genre féminin.

Dans la publicistique, également, les noms neutres ont passé surtout au masculin. Y font exception les expressions phraséologiques, les adjectifs participiaux substantivés et respectivement les noms de provenance du participe, où s'est conservé encore le neutre.

Un des problèmes les plus compliqués est, d'après l'auteur, la formation du pluriel des noms. Après une analyse détaillée, où il distingue également des périodes différentes pour ce qui est de la formation du pluriel, l'auteur aboutit à la conclusion que dans la publicistique actuelle les noms se terminant en -ak, -al, -ant, -at, -az, -ek, -el, -ier (er), -ik, -ist, -it, -os, -ot, -oz, -tar, -ur, -uz forment le pluriel à l'aide de la désinence -ë, ceux qui se terminent en -al, -an, - ar, -ent forment le pluriel tantôt en -ë, tantôt en -e; ceux qui se terminent en -iç, -il, - on le forment tantôt en -ë; tantôt en -a. L'auteur fait des remarques aussi pour le pluriel de quelques noms particuliers.

Dans la publicistique a été généralisé le pluriel en -nj au préjudice du pluriel en -j (heronj, kallinj, shkëmbenj, etc.).

La désinence en -ra est rencontrée notamment dans les pluriels des espèces (vajra, drithra, mallra). Dans les noms qui se terminent en -r on rencontre également la forme non rhotacisée de la consonne désinentielle (yndyrna, barna).

L'usage de la désinence -ër est venue perdant du terrain en faveur de la désinence -ë. En -o se terminent deux noms au pluriel: kuadro, teatro.

Le pluriel des noms féminins, fait noter l'auteur, est moins compliqué. Si dans la première phase de la publicistique, la désinence -ra était assez productive, notamment pour les noms se terminant en voyelle accentuée, prédomina petit à petit le pluriel à désinence zéro. Actuellement, la désinence -ra n'est usitée que dans les pluriels des espèces, et, dans quelques cas, aussi pour des pluriels à charge émotive (notamment péjorative).

Au pluriel inchangé aboutissent plusieurs noms qui se terminent en -ë et tous les noms qui se terminent en -e et -o.

Il y a des cas où, en raison des différences cémantiques, le même mot connaisse deux pluriels différents (pikë-pika).

Pour l'accusatif l'auteur distingue deux groupes: a) les noms qui aboutissent à un -a accentué (baba, Mustafa) et b) les noms qui aboutissent en -e, -i et -y accentués. Pour le premier groupe l'auteur croit qu'on doit généraliser d'adjonction de l'article -në directement au radical de l'accusatif (babanë), tandis que pour le deuxième il est de l'avis contraire: l'adjonction de l'article -në à un radical analogique au nominatif (Skënderbeun, njeriun). Il y a des cas d'expressions phraséologiques où le deuxième groupe également forme l'accusatif de la même façon que le premier groupe.

L'auteur fait noter que la forme en -sh de l'ablatif résulte, de par la nature même du style publicistique, d'un usage de beaucoup plus intense que dans la littérature artistique. Il y a également des cas de passage de la forme en -sh à celle en -ve; un tel passage peut être conditionné, ou bien une simple synonymie morphologique. Quelques passages de l'ablatif en -sh à l'accusatif sont déjà devenus du domaine commun de tout l'albanais.

L'article traite également de la définition des noms: la tombée en désuétude dans la publicistique actuelle albanaise du son antihyatisant -j dans les noms féminins définis (à différence des premières années après la libération du pays) et de l'article défini -t pour le pluriel des deux genres (toujours à différence des premières années). Pour les noms masculins et féminins se terminant en -o inaccentué, l'auteur, après avoir examiné l'état actuel des choses, propose à généraliser la définition par la conservation de cet o désinentiel (kostoja, çimentoja, Koçoja).

Plusieurs observations concernent également la formation des noms et notamment, les noms d'agent en -(ë)s, dont, à différence de la première période au lendemain de la libération, dans la publicistique actuellement a été généralisée la formation du participe du dialecte septentrional à -ue (shkrues, mësues, lexues). Dans l'article il est fait mention également de quelques nouveaux composés.

Pour ce qui est de l'article antérieur l'auteur fait remarquer qu'il n'y a pas des problèmes théorique insolus. On n'y observe que certains écarts de la norme littéraire commune dans l'application pratique de cette norme, comme p. ex. a) l'omission de l'article anticipé (numri-kuadrove); b) l'adaptation erronée de l'article (Punimet e Asamblesë të Kombeve të Bashkuara); c) l'accord erroné lorsque entre l'article et le nom précédant intervient un nom ou un adjectif; d) l'accord erroné lorsque le nom qui suit l'article est un nom féminin préarticulé; e) l'accord erroné au génitif-datif de l'article des noms féminins préarticulés.

Du domaine des articles, l'auteur fait plusieurs observations sur l'ordre de deux ou plusieurs adjectifs (lorsqu'on a un pronom possessif + adjectif, deux adjectifs articulés respectivement non articulés, un adjectif

articulé et un non articulé et un adjectif articlé ou non + un nom à l'ablatif).

Des observations détaillées fait l'auteur également sur la formation des adjectifs à l'aide du suffixe -shëm (dans la première phase: i vazhduarshëm / i vazhduar, i mjaftuëshëm, i mjaftueshëm, tandis qu'actuellement est généralisé le type: i mjaftueshëm).

Il y est fait noter également le parallélisme entre les noms aux cas indirects et les adjectifs à sens d'appartenance. Il y est traitée aussi le changement des anciens noms milion et miliard en adjectifs.

Du domaine des pronoms, l'auteur fait noter qu'une attention particulière méritent seulement les écarts éventuels dans la stabilisation de la norme. Par ces écarts, il mentionne: 1) les formes de la Ire et II^e personne des pronoms personnels neve et juve pour ne et ju; 2) sur l'adoption erronée des formes brèves des pronoms personnels: a) III^e personne du singulier au lieu de la III^e personne du pluriel; b) iu pour u; c) ia pour ua, jua et jau pour ua; d) u pour ju.

En ce qui concerne les pronoms possessifs il analyse en détail l'état non encore normalisé qui existait à la veille de la libération du pays et la stabilisation graduelle des formes généralisées dans l'albanais littéraire commun.

L'auteur fait noter enfin l'extension de plus en plus grande que trouve le pronom possessif i(e)vet au dépens de i(e) tij.

En conclusion l'auteur fait noter que la publicistique des années d'après la libération du pays et notamment son système nominal confirme de la façon la plus heureuse la collaboration interdialectale intervenue après la stabilisation de la langue commune littéraire nationale. Il y est fait ressortir le mérite indiscutable des différentes éditions d'orthographes publiées après la libération du pays en vue de l'unification de la norme littéraire commune. Actuellement on n'est plus en présence d'un mélange mécanique des éléments du dialecte septentrional, qui ne sont pas en petit nombre, avec ceux du dialecte méridional qui en constitue la base, mais un enchevêtrement organique des deux dialectes. L'auteur fait remarquer qu'en général, dans le système nominal se sont cristallisées des normes linguistiques communes. Néanmoins il y a encore un nombre relativement grand d'écarts des formes constituant la norme. Enfin, l'auteur fait noter aussi que le système nominal de la publicistique albanaise, par rapport au système nominal de la littérature artistique présente, dans quelques aspects, certaines différences.